

**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS (DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA)**

E mbledhur në ndërtesën e Gjykatës së Apelit në Prishtinë

Lënda numër: **P. Nr. 448/2012**

Datë: **7 qershor 2013**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS (DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA)** në Trupin Gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Jonathan WelfordCarroll, si kryetar i trupit gjykues, Gjyqtarja e Republikës së Kosovës Shadije Gerguri dhe Gjyqtari i EULEX-it Cezary Dziurkowski, si anëtarë të Trupit Gjykues, me pjesëmarrjen e oficerës ligjore të EULEX-it, Emiliya Viktorova, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër:

**L.G., N.M., R.M.**

Të Akuzuarit **L.G., N.M. dhe R.M.**, të akuzuar sipas Akuzës 8 të Aktakuzës së Përmirësuar, Hep. nr. 65/2002, datë 30 qershor 2003, e kufizuar në ngjarjet që pretendohet të kenë ndodhur vetëm në kampin e Llapashticës, me këto vepra penale, të ndjekura sipas detyrës zyrtare:

**Akuza 8:**

*Krim lufte kundër popullatës civile, në veçanti, trajtim çnjerëzor, shkaktim i vuajtjeve të mëdha ose cenim i integritetit trupor ose shëndetit, zbatim i masave të frikësimit dhe terrorit, dhe torturë, në shkelje të Nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 44, datë 8 tetor 1976) (KPRSFJ), lidhur me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPRSFJ-së, sepse nga tetori 1998 deri në fund të prillit 1999, **L.G., N.M., dhe R.M.**, me përgjegjësi të lartë dhe personale, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë të paidentifikuar dhe në zbatim të një sipërmarrjeje të përbashkët kriminale, urdhëruan dhe morën pjesë në rrahjen dhe torturimin civilëve shqiptarë të Kosovës, të paraburgosur në mënyrë të paligjshme në qendrën e paraburgimit të ndodhur në Llapashticë, në përpjekje për t'i detyruar këta të paraburgosur të pranojnë se kanë kryer akte të tradhtisë ndaj UÇK-së.*

PASI zhvilloi seancën e shqyrtimit paraprak më 26 shkurt 2013 dhe seancat e shqyrtimit gjyqësor të hapura për publikun më 25, 26 dhe 27 mars 2013, 3, 4 dhe

11 prill 2013, 7, 8, 10 dhe 22 maj 2013 dhe 4 dhe 7 qershor 2013, si dhe seancën pjesërisht të mbyllur më 11 prill 2013, ku në proces-verbalin e shqyrtimit gjyqësor u shënuan shënimet personale të dëshmitarëve të mbrojtur I, C dhe P;

PAS zhvillimit të seancave të mësipërme në prani të të Akuzuarit **L.G.** dhe Mbrojtësit të tij M.S. ose B.T., të Akuzuarit **N.M.** dhe Mbrojtësit të tij F.B., të Akuzuarit **R.M.** dhe Mbrojtësit të tij A.R., ose përfaqësuesve zëvendësues me rregull, dhe Prokurorit Special të EULEX-it, Charles Hardaway, të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës;

PAS këshillimit dhe votimit të Trupit Gjykses të Shqyrtimit Gjyqësor, të mbajtur më 6 qershor 2013;

Në bazë të Nenit 3 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), nr. 04/L-082, i shpallur më 20 prill 2012, i hyrë në fuqi më 1 janar 2013, dhe Nenit 351 të Ligjit të Procedurës Penale (LPP) (Gazeta Zyrtare nr. 26/86), sot më 7 qershor 2013, në seancë gjyqësore të hapur dhe në prani të të Akuzuarve, Mbrojtësve të tyre dhe Prokurorit Special të EULEX-it;

*shqipton këtë*

---

## AKTGJYKIM

---

**1. L.G., N.M. dhe R.M.,** secili me shënimet personale si më lart,

**SHPALLEN**, në bazë të Nenit 351 të LPP-së:

**FAJTORË** për *krime luftarë kundër popullatës civile*, në veçanti, trajtim çnjerëzor, shkaktim të vuajtjeve të madhe ose cenim të integritetit trupor ose shëndetit, zbatim të masave të frikësimit dhe terrorit, dhe torturë, në shkelje të Nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 44, datë 8 tetor 1976) (KPRSFJ), lidhur me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPRSFJ-së, sepse nga tetori i vitit 1998 deri në fund të prillit 1999, **L.G., N.M., dhe R.M.,** me përgjegjësi të lartë dhe personale, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë të paidentifikuar dhe në zbatim të një sipërmarrjeje të përbashkët kriminale, urdhëruan dhe morën pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës, të paraburgosur në mënyrë të paligjshme në qendrën e

paraburgimit të ndodhur në Llapashticë, në përpjekje për t'i detyruar këta të paraburgosur të pranojnë se kanë kryer veprime tradhtie ndaj UÇK-së.

NË BAZË TË neneve 41 dhe 42, të KPRSFJ-së dhe Nenit 351, paragrafi 3, të LPP-së, të Akuzuarit dënohen si më poshtë në lidhje me Akuzën 8:

1. **L.G.**, me shënimet personale si më lart, dënohet me **5 vjet** burgim.
2. **N.M.**, me shënimet personale si më lart, dënohet sipas Akuzës 8 me **3 vjet** burgim.
3. **R.M.**, me shënimet personale si më lart, dënohet sipas Akuzës 8 me **4 vjet** burgim.

DUKE MARRË PARASYSH dënimet e veçanta në lidhje me Akuzën 5 (*krime të luftës kundër popullatës civile, në kundërshtim me Nenin 142 të KPRSFJ-së*), **L.G.** 2 vjet burgim, **N.M.** 1 vit e gjashtë muaj burgim, dhe **R.M.** 2 vjet burgim, dhe Akuzën 14 (*krime të luftës kundër popullatës civile, në kundërshtim me Nenin 142 të KPRSFJ-së*), **L.G.** 2 vjet burgim, siç është përcaktuar nga Gjykata e Qarkut Prishtinë në Aktgjykimin e saj të datës 2 tetor 2009 dhe të lënë në fuqi nga Gjykata Supreme e Kosovës në Aktgjykimin e saj të datës 26 janar 2011;

DUKE VËREJTUR SE Gjykata Supreme e Kosovës në Aktgjykimin e saj të datës 26 janar 2011 e udhëzoi këtë Trup Gjykses të përcaktojë dënimin unik që duhet caktuar ndaj **L.G.** në lidhje me Akuzat 5, 8 dhe 14, ndaj **N.M.**, në lidhje me Akuzat 5 dhe 8, dhe ndaj **R.M.**, në lidhje me Akuzat 5 dhe 8;

Në bazë të Nenit 48, paragrafi 2, të KPRSFJ-së dhe Nenit 357, paragrafi 5, të LPP-së, dënimet unike përcaktohen si më poshtë:

1. **L.G.**, me shënimet personale si më lart, do të vuajë dënimin unik sipas Akuzave 5, 8 dhe 14 prej **6 vjetësh** burgim.
2. **N.M.**, me shënimet personale si më lart, do të vuajë dënimin unik sipas Akuzave 5 dhe 8 prej **3 vjetësh** burgim.
3. **R.M.**, me shënimet personale si më lart, do të vuajë dënimin unik sipas Akuzave 5 dhe 8 prej **4 vjetësh** burgim.

Në bazë të Nenit 50 të KPRSFJ-së dhe Nenit 351, paragrafi 1, nën-paragrafi 6 të LPP-së, të Akuzuarit kanë të drejtën e përfshirjes në dënim të kohës së kaluar në paraburgim deri tani.

### **ARSYETIM**

### **HYRJE DHE FORMALITETE**

1. Trupi Gjykses i Rishqyrtimit të Dytë dëgjoi seancat në shqyrtimin gjyqësor të L.G.t dhe të tjerët në datat:
  - a. 26 shkurt 2013 – takimi i përbashkët për statusin e procedurës paraprake.
  - b. Seancat e shqyrtimit gjyqësor
    - i. 25 mars 2013 – hapja e lëndës, shënimet personale dhe çështje prezantuese e paraprake.
    - ii. 26 mars 2013 – Dëshmia e L.G., e N.M.. iii. 27 mars 2013 – Dëshmia e N.M. (vazhdimi), e R.M..
    - iv. 3 prill 2013 – dëshmitari 4 nuk mori pjesë, u lëshua Urdhri për sjelljen forcërisht.
    - v. 4 prill 2013 – Dëshmia e R.B. (më parë i njohur si Dëshmitari 7).
    - vi. 10 prill 2013 – shqiptohet vendimi për të lejuar leximin e dëshmisë së Dëshmitarit V për shkak se dëshmitari kishte vdekur. vii. 11 prill 2013 – Dëshmitë e Dëshmitarit I, Dëshmitarit C, Dëshmitarit P.
    - viii. 7 maj 2013 – Dëshmitari V.J. nuk mori pjesë. Ndërmjet palëve u arrit marrëveshje lidhur me një listë të dëshmitarëve deklaratat e të cilëve të lexoheshin dhe përfshiheshin në proces-verbal (konkretisht, dëshmitarët H, J, D, E, G, F, V.J., M, F.M., K.H., G.Z., S.G.). Dëshmia e Dëshmitarit V lexohet dhe përfshihet në proces-verbal për shkak të vdekjes së tij (sipas Urdhrit të lëshuar më 10/04/2012).
    - ix. 8 maj 2013 – dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, K.K. dhe N.I., lexohen dhe shënohen në proces-verbal me marrëveshje (shih proces-verbalin e datës 08/05/2013 f. 29 dhe të datës 10/05/2013, f. 14. Dëshmia e A.A. (më parë i njohur si Dëshmitari 4).
    - x. 10 maj 2013 – Dëshmia e A.A. (vazhdimi)
    - xi. 22 maj 2013 – fjala përfundimtare e akuzës.
    - xii. 4 qershor 2013 – fjalët përfundimtare të mbrojtjes.
    - xiii. 7 qershor 2013 – shpallja e Aktgjykimit.

## **LISTA E DËSHMIVE DHE PROVAVE**

2. Trupi Gjykses shqyrtoi materialet e mëposhtme
  - a. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, datë 16 korrik 2003 - C. Nr. 425/2001;
  - b. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, datë 21 korrik 2005 - AP. KZ 139/2004;

- c. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, datë 2 tetor 2009 - P. Nr 526/05;
- d. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, datë 26 janar 2011 - Ap. KZ 89/2010;

### **AKTVENDIMET LIGJORE TË SHQIPTUARA NË LËNDË**

1. Para fillimit të rishqyrtimit gjyqësor të dytë, u ngrit një çështje lidhur me formën e saktë të Aktakuzës, dhe shtrirjen e kësaj Aktakuze për rishqyrtimin gjyqësor. Akuza kërkoi që të mbështetej në një Aktakuzë të Përmirësuar, por mbrojtja kundërshtoi. Më datë 06/03/2013, Kryetari i Trupit Gjykues lëshoi një Aktvendim me shkrim, i cili është bashkëngjitur dhe shënuar këtu si 'Shtojca A', dhe i konsideruar si i përfshirë në tërësi në këtë arsyetim.
2. U ngrit edhe çështja lidhur me Kodin Procedural të saktë që duhej zbatuar në rishqyrtimin gjyqësor. Në datën 06/03/2013, Kryetari i Trupit Gjykues nxori Aktvendim me shkrim, bashkëngjitur këtij Aktgjykimi, i shënuar si 'Shtojca A' dhe i konsideruar si i përfshirë në tërësi në këtë arsyetim.
3. Në seancën gjyqësore dhe në prani të palëve, Kryetari i Trupit Gjykues dha një aktvendim me gojë, me të cilin hidhej poshtë kërkesa e Akuzës për t'i përjashtuar të bashkë-pandehurit nga salla e gjyqit ndërkohë që secili i pandehur jepte deklaratën e tij. Kushtet e plota të aktvendimit përvijohen në proces-verbalin e datës 26/03/2013, f. 2-3.
4. U nxor një Aktvendim lidhur me leximin dhe përfshirjen në proces-verbal të dëshmisë së Dëshmitarit V, për shkak të vdekjes së këtij dëshmitari. Aktvendimi i datës 10/04/2013 i është bashkëngjitur këtij Aktgjykimi dhe është shënuar si 'Shtojca B'.
5. Trupi Gjykues shqiptoi një vendim për të pranuar dëshmitë me shkrim të një numri dëshmitarësh [H, J, D, E, G, F, V.J., M, F.M., K.H., G.Z., dhe S.G.], të cilët nuk mundën të marrin pjesë në seancë gjyqësore, duke i lexuar dhe përfshirë ato në proces-verbalin e shqyrtimit gjyqësor, bazuar në marrëveshjen përkatëse me shkrim dhe të nënshkruar nga palët, të datës 07/05/2013 (LPP, Neni 333(2)). Marrëveshja e nënshkruar i është bashkëngjitur këtij Aktgjykimi dhe është shënuar 'Shtojca C'. Trupi Gjykues vendosi të pranojë dëshmitë e dy dëshmitarëve të tjerë [K.K. dhe N.I.], të cilët nuk mundën të marrin pjesë në seancë gjyqësore, me marrëveshje të palëve (shih proces-verbalin e datës 08/05/2013, f. 29 dhe atë të datës 10/05/2013, f. 14) Marrëveshja i është bashkëngjitur këtij Aktgjykimi si 'Shtojca D'.

6. Aktvendim lidhur me deklaratat fillestare në polici të këtyre dëshmitarëve: R.B. (Deklarata e datës 20/08/2002), Dëshmitari C (Deklarata e datës 03/06/2000), Dëshmitari D (deklaratat e datave 06/03/2000 dhe 17/08/2001), Dëshmitari E (deklaratat e datave 06/03/2000, 21/03/2000 dhe 17/08/2001), Dëshmitari F (Deklarata e datës 21/03/2000), Dëshmitari G (Deklarata e datës 17/08/2001), Dëshmitari H (Deklarata e datës 23/01/2000) dhe Dëshmitari P (deklarata pa datë).

Në secilin rast dëshmitarët e identifikuar më lart kishin dhënë deklaratë të shkurtër në police, para se të merreshin në pyetje më pas nga Gjyqtarja Hetuese. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 04/04/2013, Mbrojtësi M.S. kundërshtoi çdo përdorim që mund t'i bëhej Deklaratës së R.B., me arsyetimin se ajo nuk i ishte dorëzuar asnjëherë mbrojtjes në ndonjë fazë të procedurës. Trupi Gjykues mbajti pikëpamjen se Deklarata e R.B. duhej t'i dorëzohej mbrojtjes dhe Prokurori u pajtua. Kjo u bë, por u desh një kohë e gjatë deri sa Deklarata të përkthehej dhe të shqyrtohej nga Mbrojtja, para se të dëgjohej dëshmitari. Prandaj Trupi Gjykues e rishikoi vendimin fillestar të tij dhe mbajti qëndrimin që nuk duhej përdorur asnjëra nga deklaratat e dhëna nga ndonjë dëshmitar para dëgjimit të atij dëshmitari nga Gjyqtarja Hetuese. Ky vendim u mor me qëllimin e drejtësisë ndaj palëve dhe ekonomizimit të procesit të shqyrtimit gjyqësor (shih proces-verbalin e datës 04/04/2013, f. 3-8, të datës 11/04/2013, f. 9). Për të shmangur çdo dyshim, çdo përshkrim i mëparshëm i bërë nga ndonjë dëshmitar, që ishte vlerësuar nga Trupi Gjykues në arritjen e aktgjykimit të tij, ravijëzohet plotësisht brenda këtij Aktgjykimi të shkruar.

7. Aktvendim lidhur me pranueshmërinë e proces-verbalit të seancës dëgjimore të R.B. para Gjyqtarës Hetuese më datë 23/08/2002, me arsyetimin se zhvillimi i asaj seance nga Gjyqtarja Hetuese kishte shkelur LPP-në. Trupi Gjykues e hodhi poshtë këtë kërkesë dhe arsyetimi i plotë u dha me gojë në seancën e shqyrtimit gjyqësor në prani të palëve (shih proces-verbalin e datës 04/04/2013, f. 7)
8. Aktvendim lidhur me pranueshmërinë e proces-verbalit të Dëshmisë së A.A. (më parë i njohur si Dëshmitari 4) të dhënë para Gjyqtarës Hetuese më 14 maj 2002 dhe 18 tetor 2002. Në seancën dëgjimore të A.A. (më parë i njohur si Dëshmitari 4) më 14 maj 2002 para Gjyqtarës Hetuese, nuk ishte prezent, madje nuk u thirr, asnjë Mbrojtës. Nga kjo rrjedh se mbrojtjes nuk iu dha mundësia të merrte në pyetje dëshmitarin nga ana e saj. Më 18 tetor 2002, A.A. u intervistua përsëri nga Gjyqtarja Hetuese. Me këtë rast u thirrën 7 mbrojtës, dhe 3 morën pjesë. Në shqyrtimin gjyqësor të datës 20 mars 2003, Mbrojtja dha argumente për përjashtimin e proces-verbalit të

seancës dëgjimore të datës 18 tetor 2002, me arsyetimin se dëshmitari duket ka përdorur proces-verbalin ose shënimet e veta të seancës dëgjimore të 14 majit. Trupi Gjykues në vitin 2002 e hodhi poshtë atë kërkesë duke deklaruar se çdo çështje lidhur me procesverbalin e tetorit mund të vlerësohet brenda procesit të zakonshëm të shqyrtimit gjyqësor. Proces-verbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 20 mars 2002 nuk tregon nëse u bë ndonjë argumentim konkret apo nëse u nxor ndonjë vendim nga Trupi Gjykues lidhur me proces-verbalin e intervistës së datës 14 maj, ndonëse, po t'i referohemi marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Trupi Gjykues në vitin 2002, duket se ata iu referuan vetëm proces-verbalit të tetorit.<sup>1</sup> Në shqyrtimin gjyqësor të vitit 2009, mbrojtja ngriti sërish çështjen e pranueshmërisë së proces-verbaleve të majit dhe tetorit të A.A. para Gjyqtarës Hetuese, bashkë me çështje të tjera lidhur me një sërë dëshmitarësh të tjerë. Kryetari i Trupit Gjykues nxori aktvendim që i bashkonte të gjitha çështjet, por ishte i paqartë, megjithëse dukej se ai arrinte në përfundimin se Trupi Gjykues i vitit 2002 e kishte përjashtuar proces-verbalin e majit dhe kishte pranuar proces-verbalin e tetorit. Trupit Gjykues i vitit 2009 vendosi në të njëjtën mënyrë, domethënë, e përjashtoi proces-verbalin e majit dhe pranoi proces-verbalin e tetorit.<sup>2</sup> Para Trupit Gjykues në vitin 2013, Mbrojtja ngriti përsëri të njëjtat kundërshtime lidhur me proces-verbale të dëgjimit të A.A. para Gjyqtarës Hetuese më 14 maj dhe 18 tetor 2002.

- a. Ky Trup Gjykues u kushtoi vëmendje të dy vendimeve të mëparshme dhe e shqyrtoi këtë çështje sërish. Ky Trup Gjykues gjithashtu vëren se Prokurori tani para nesh e pranon atë aktvendim të mëparshëm, nuk ka ndërmend ta kundërshtojë atë dhe pajtohet që të mos mbështetet në asnjë aspekt në procesverbalin e 14 majit 2002. Për sa i takon proces-verbalit të 14 majit 2002, është e qartë se Mbrojtësit nuk ishin prezent dhe nuk patën mundësi ta merrnin në pyetje dëshmitarin. Neni 168(4) i LPP-së parashikon rrethanat në të cilat Mbrojtësit janë të pranishëm në ekzaminimin e dëshmitarëve, kurse neni 168(8) mishëron të drejtën që pyetjet, qartësimet dhe sqarimet e mbrojtjes të shënohen në proces-verbal. Ky Trup Gjykues ka bindjen se procesverbali i dëgjimit të A.A. para Gjyqtarës Hetuese më 14 maj 2002 duhet përjashtuar nga provat, duhet veçuar nga shkresat e lëndës dhe nuk duhet shqyrtuar më tutje.
- b. Për sa i përket proces-verbalit të seancës dëgjimore të datës 18 tetor 2002, situata është kryekëput e ndryshme. Në atë rast, dëshmitari u dëgjua në prani të Mbrojtësve. Trupi Gjykues pranon se proces-

---

<sup>1</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/03/2002, f. 4

<sup>2</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 18/09/2009, f. 4-5

verbali deklaron me saktësi praninë e Mbrojtësve. Mbrojtësit ishin krejt të pakufizuar në të drejtën e tyre për të bërë pyetje. Çështjet e ngritura nga Mbrojtësit në kundërshtimin e pranueshmërisë së proces-verbalit të 18 tetorit 2002 kanë të bëjnë vetëm me çështjet e besueshmërisë dhe peshës së dëshmisë së A.A., dhe jo me çështjen e pranueshmërisë. Bazat për ta përjashtuar këtë dëshmi nuk ekzistojnë dhe, për këtë arsye, ky Trup Gjykues e hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes dhe e pranon dëshminë.<sup>3</sup>

#### 9. Aktvendim lidhur me ditarin mungues të **L.G.**

- a. Në emër të **L.G.**, M.S. ngriti ankesën se një dokument që ai e vlerësonte të rëndësishëm, konkretisht Ditari i Luftës i **L.G.**, kishte humbur në ndonjë fazë gjatë procedurës dhe prandaj nuk ishte në zotërim të tij për ta ndihmuar në mbrojtjen e tij.<sup>4</sup> Akuza u urdhërua t'i paraqesë një raport Trupit Gjykues, ku të paraqiste në mënyrë të hollësishme historinë se çfarë kishte ndodhur me ditarin, dhe Akuza e zbatoi atë urdhër më 18/04/2013.
- b. Ky hetim dhe shqyrtimi gjyqësor i parë u kryen nën UNMIK-un. Në një fazë të caktuar, shkresat e lëndës iu dorëzuan EULEX-it. Prokurori nuk mund të shpallet përgjegjës për përmbajtjen e atyre shkresave të lëndës gjatë kohës që ato ishin në zotërim dhe kontrolli të UNMIK-ut. Në rishqyrtimin gjyqësor të vitit 2009, u bë e qartë se ditari kishte humbur.<sup>5</sup> Si rezultat i urdhrit të Trupit Gjykues të vitit 2013, u bë një rishqyrtim i të gjitha shkresave të lëndës, tashmë në zotërim të Prokurorit dhe gjykatës. Ditari nuk u gjet. Duhet menduar se ai ka humbur në ndonjë fazë ndërmjet shqyrtimit gjyqësor të parë në vitin 2003 dhe rishqyrtimit gjyqësor në vitin 2009.
- c. Trupi Gjykues arrin në përfundimin se për të gjetur ditarin u ndërмор çdo gjë e mundshme. Mungesa e tij nuk përbën bazë për të penguar vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor. Qëllimi parësor i këtij dokumenti do të ishte një ndihmë kujtimesh të **L.G.** në dhënien e dëshmisë së tij. Por, sidoqoftë, **L.G.** ka dhënë dëshmi të hollësishme, që është shënuar në proces-verbale në disa raste të mëhershme, përfshirë që në vitin 2002. **L.G.** nuk mund t'i shkaktohet asnjë paragjykim madhor për arsye të mungesës së ditarit të tij. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se **L.G.** deklaron se ai e nisi ditarin e tij në burg, d.m.th. ai nuk është dokument i njëkohshëm, ndonëse ai pohon edhe të kundërtën, prandaj pozicioni i vërtetë nuk është i

---

<sup>3</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 08/05/2013, f. 3-7

<sup>4</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 25/03/2002, f. 12

<sup>5</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 18/09/2009, f. 6



qartë.<sup>6</sup> Ditari nuk mund të vlerësohej si provë vërtetuese e dëshmimit të **L.G.**, ngase ky i fundit është vetë autori i atij Ditari. Prandaj ai nuk është i pavarur prej tij, por thjesht një burim tjetër i dëshmimit të tij. Mungesa e ditarit nuk e pengon zhvillimin e një shqyrtimi gjyqësor të drejtë për **L.G.**.

10. Aktvendimi lidhur me pranueshmërinë e Deklaratës së **R.M.** dhënë Gjyqtares Hetuese më 13/08/2002. Kjo Deklaratë u përjashtua nga Trupi Gjyqësor i parë më 14/03/2003, për arsye të gabimit të rëndë procedural, sepse **R.M.** nuk i ishte dhënë paralajmërimi i saktë si i akuzuar, para se të jepte deklaratën e tij. Gabimisht Gjyqtari Hetues i shqiptoi **R.M.** paralajmërimin si dëshmitar në bazë të Nenit 231(2) të LPP-së, duke deklaruar se ai ishte i detyruar të tregonte të vërtetën, ndërkohë që ai duhej t'i kishte shqiptuar të drejtat e të Akuzuarit sipas neneve 67 dhe 218(2) & (3) të LPP-së. Qartazi kjo ishte e gabuar dhe në dëm të mundshëm të konsiderueshëm për të pandehurin. Si në rishqyrtimin gjyqësor në vitin 2009, ashtu dhe në rishqyrtimin gjyqësor në vitin 2013, nuk u bë asnjë debat i mëtejshëm konkret lidhur me këtë pikë. Prandaj ky Grup Gjyqësor vlerëson se vendimi i parë i Trupit Gjyqësor të Shqyrtimit Gjyqësor të vitit 2003 ende qëndron. Për këtë arsye, Deklarata e **R.M.** dhënë Gjyqtares Hetuese më datë 13/08/2002 mbetet e përjashtuar nga provat dhe veçohet nga shkresat e lëndës. Ky Grup Gjyqësor nuk e merr aspak parasysh këtë Deklaratë në arritjen e aktgjykimit të tij.

11. Udhëzimi lidhur me propozimet me shkrim për redaktimin/korrigjimin e proces-verbalit. Në një sërë rastesh, **L.G.** ngriti ankesa për saktësinë e proces-verbalit të shqyrtimit gjyqësor ose të përkthimeve të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor. Mbrojtësit e tij pranuan se asnjë prej këtyre gabimeve nuk ishte material dhe nuk ndikonte në saktësinë dhe drejtësinë e përgjithshme të proces-verbalit. Kryetari i Trupit Gjyqësor u lëshoi një udhëzim palëve për të paraqitur kundërshtime / propozime me shkrim për korrigjime të proces-verbalit të shqyrtimit gjyqësor, duke treguar datën, faqen dhe pasazhin përkatës që kundërshtohet. Në datën e përpilimit të këtij Aktgjykimi, asnjë propozim i tillë me shkrim nuk u dorëzua nga ndonjëra palë (shih proces-verbalin e datës 10 maj 2013).

## HISTORIA PROCEDURALE

12. Aktakuza e parë kundër **L.G.**, **N.M.** dhe **R.M.** u ngrit më 19 nëntor 2002 në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, më pas e përmirësuar më 4 shkurt dhe 30

---

<sup>6</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 24/06/2002 f. 6 & f. 10

qershor 2003, ku pretendoheshin një numër akuzash të krimeve të luftës kundër popullatës civile, në kundërshtim me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (këtej e tutje 'KPRSFJ'), Neni 142, sipas Rregullores 1999/24 të UNMIK-ut, e ndryshuar me Rregulloren 2000/59 të UNMIK-ut. Tani është Aktakuza e Përmirësuar e 30 qershorit 2003, Akuza 8, ajo që është vendosur para Trupit Gjyqësor të këtij Rishqyrtimi Gjyqësor, ndërkohë që ndaj **L.G.** ekziston tashmë një aktgjykim dënues përfundimtar për Akuzat 5 dhe 14, kurse ndaj **N.M.** dhe **R.M.** ekziston tashmë një aktgjykim dënues përfundimtar për Akuzën 5 të Aktakuzës së Përmirësuar në fjalë.

13. Shqyrtimi gjyqësor (i parë) i shkallës së parë u mbajt në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, e cila më 16 korrik 2003 shqiptoi aktgjykimin e saj, që rrëzonte plotësisht disa prej akuzave dhe disa elemente të disa akuzave dhe i dënoi të tre të pandehurit për elementet e mbetura për veprën e krimeve të luftës kundër popullatës civile (Akuza 5, Akuza 8 [vetëm në Llapashticë] dhe Akuza 14), duke i dënuar ata si më poshtë: **L.G.** me 10 vjet burgim, **N.M.** me 13 vjet burgim dhe **R.M.** me 17 vjet burgim.
14. Pas Ankesës së Mbrojtjes kundër të gjitha dënimeve dhe Ankesës së Akuzës vetëm kundër dënimit për **L.G.**, më datë 21 korrik 2005 Gjykata Supreme e Kosovës në lëndën Ap Kz 139/2004 shqiptoi vendim me të cilin ajo 'anuloi në tërësi' Akuzat 1, 2, 3 dhe 12, shqiptoi lirim nga akuza për Akuzën 11, ndërsa Akuzat e mbetura u kthyen për rishqyrtim gjyqësor.
15. Trupi Gjyqësor i Rishqyrtimit të Parë në vitin 2009 (P526/05) zhvilloi rishqyrtimin gjyqësor, duke i marrë sërish dëshmitë dhe provat lidhur me Akuzat 5, 9 dhe 14 të Aktakuzës së Përmirësuar të 30 qershorit 2003 [SHËNIM: më 8 korrik 2009 u propozua një Aktakuzë tjetër e Përmirësuar, por ajo u hodh poshtë nga Trupi Gjyqësor i Rishqyrtimit, prandaj komentet e më tutjeshme nuk janë të nevojshme]. Lidhur me Akuzën 8, Trupi Gjyqësor i Rishqyrtimit të Parë përcaktoi se dëshmitë dhe provat ishin marrë tashmë në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme (pozicion me të cilin Gjykata Supreme në ankesën e parë ishte pajtuar plotësisht) dhe, për këtë arsye, u kufizua në rishqyrtimin e dënimit. Gjatë procedurës, Prokurori e tërhoqi Akuzën 9. Më 2 tetor 2009 (lidhur me vonesën prej 4 vjetësh nuk ka shpjegim!), Trupi Gjyqësor i Rishqyrtimit të Parë i dënoi të pandehurit si më poshtë:
  - a. **L.G.**, për krime të luftës kundër popullatës civile sipas Akuzës 5 (dënimi 2 vjet burgim), Akuzës 8 (dënimi 5 vjet burgim) dhe Akuzës 14 (dënimi 2 vjet burgim) – dënimi unik 6 vjet burgim.

- b. **N.M.** për krime të luftës kundër popullatës civile, për Akuzën 5 (dënimi 1 vit e 6 muaj burgim) dhe Akuzën 8 (dënimi 3 vjet burgim) – dënimi unik 3 vjet burgim.
- c. **R.M.** për krime të luftës kundër popullatës civile, për Akuzën 5 (dënimi 2 vjet burgim) dhe Akuzën 8 (4 vjet burgim) – dënimi unik 4 vjet.

16. Më 15, 16, dhe 18 shkurt 2010, të tre të pandehurit paraqitën ankesë kundër dënimeve dhe masës së këtyre dënimeve. Prokurori nuk paraqiti ankesë kundër masës së dënimeve.

17. Më 26 janar 2011 (Ap-Kz 89/2010), Gjykata Supreme shqiptoi aktgjykimin a saj në të cilin u lanë në fuqi vendimet e Rishqyrtimit Gjyqësor të Shkallës së Parë për Akuzat 5 dhe 14. Meqenëse kundër këtij vendimi nuk u bë ankesë shtesë, këto dënime dhe masa të dënimeve u bënë përfundimtare. Gjykata Supreme e rrëzoi dënimin për Akuzën 8 dhe ia ktheu atë Gjykatës së Qarkut për rishqyrtim gjyqësor të dytë. Baza e atij vendimi ishte mosdëgjimi sërish nga Trupi Gjyqësor i Rishqyrtimit të Parë i dëshmitarëve lidhur me Akuzën 8. Trupi Gjyqësor i parë i vitit 2003 kishte dhënë dënim lidhur me Akuzën 8 të Aktakuzës së Përmirësuar të 30 qershorit 2003 vetëm në lidhje me ngjarjet në qendrën e paraburgimit në Llapashticë. Trupi Gjyqësor shqiptoi lirim nga akuza për ngjarjet brenda Akuzës lidhur me Majacin dhe Potokun. Ai aktgjykim u shqyrtua nga Gjykata Supreme e cila, në vendimin e saj të datës 21 korrik 2005, gjeti se asnjëra prej ankesave të Mbrojtjes nuk kishte bazë në lidhje me këtë aktgjykim dhe, në veçanti, arriti në përfundimin se provat ishin siguruar në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme, në pajtim me Kodin Procedural. Megjithatë, Gjykata Supreme ia ktheu Akuzën gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim, me arsyet se aktgjykimin i parë 'i trajtonte akuzat e ndryshme në Aktakuzë si një krim i vetëm lufte për sa i përket secilit të pandehur'! Lidhur me këtë Akuzë, Trupi Gjyqësor i Rishqyrtimit të Parë shqyrtoi detyrimin e tij sipas vendimit të Gjykatës Supreme për t'u kufizuar në çështjen e masës së dënimit, por ky shqyrtim i Akuzës mbetet i kufizuar vetëm për ngjarjet në Llapashticë, sepse lirimi nga akuza lidhur me ngjarjet në Majac dhe Potok kishte marrë formë të prerë. Si rezultat i këtij qëndrimi, Trupi Gjyqësor i Rishqyrtimit të Parë nuk i dëgjoi dëshmitarët sërish, i dënoi të pandehurit dhe rishqyrtoi dënimet e vendosura. Duke pasur parasysh se vendimi i parë i Gjykatës Supreme faktikisht nuk kishte gjetur asgjë të gabuar në lidhje me dëshmitë dhe provat e para, as me kuptimin nga Trupi Gjyqësor të këtyre dëshmitëve dhe provave, dhe i gjeti të gjitha ankesat e mbrojtjes pa bazë dhe e ktheu lëndën për rishqyrtim gjyqësor vetëm për arsye mjaft teknike, është ndoshta tërësisht e kuptueshme që Trupi Gjyqësor i Rishqyrtimit të Parë mbrojti atë pikëpamje. Është për të ardhur shumë keq që dëshmitarëve të

cilët tashmë kishin dhënë dëshmi të qarta, koherente dhe të pranueshme për ngjarje tejet traumatike, duhej t'u kërkohej ta bënin këtë gjë përsëri. Megjithatë, vendimi i dytë i Gjykatës Supreme më datë 26 janar 2011 kërkon pikërisht këtë.

18. Prandaj, është detyrë e Trupit Gjykses të Rishqyrtimit të Dytë të rigjykojë vetëm Akuzën 8, duke u kufizuar në ngjarjet në Llapashticë, dhe të rimarrë përsëri në pyetje dëshmitarët përkatës (në varësi të ndonjë marrëveshjeje ndërmjet palëve për të lexuar dhe përfshirë në procesverbal proces-verbalet e dëgjimit të dëshmitarëve, ose për të urdhëruar përfshirjen në proces-verbal të proces-verbaleve të dëgjimit të dëshmitarëve për shkaqe të tilla si vdekja ose mosgjetja e dëshmitarëve.) Më tej, meqenëse Prokuroria nuk u ankua asnjëherë ndaj masës së dënimit të caktuar, Trupi Gjykses i Rishqyrtimit të Dytë është i kufizuar, për shkak të dënimit maksimal, në dënimin e vendosur lidhur me këtë Akuzë nga Trupi Gjykses i Rishqyrtimit të Parë. Pasi ta ketë ndërmarrë këtë detyrë, pastaj Trupi Gjykses i Rishqyrtimit të Dytë duhet të shqyrtojë dënimin e duhur unik për secilin të pandehur.
19. Së fundi, është e nevojshme që Trupi Gjykses i Rishqyrtimit të Dytë të bëjë disa komente se si duhen kuptuar aktgjykimet me shkrim si të Trupit Gjykses të Rishqyrtimit të Parë, ashtu dhe të vendimeve të Gjykatës Supreme. Kjo detyrë është penguar nga përdorimi gjerësish dhe krejt i padobishëm i shprehjeve latine në aktgjykimet e mëparshme. Aktgjykimet synohen në radhë të parë që të kuptohen nga palët, domethënë, të pandehurit, të dëmtuarit dhe dëshmitarët, shumica e të cilëve nuk janë juristë me shkollë. Përdorimi gjerësisht i latinishtes thjesht fsheh dhe pështjellon kuptimin e vërtetë të aktgjykimit nga ata që preken më së shumti prej tij dhe, kësisoj, shërben vetëm për të pështjelluar ligjin dhe procedurën e tij.

## **KUSHTET LIGJORE PARAPRAKE**

20. **Juridiksioni i gjykatës dhe përbërja e Trupit Gjykses** - Në bazë të Ligjit për Procedurën Penale (Gazeta Zyrtare nr. 26/86) Kapitulli II, "Juridiksionet e Gjykatave", Neni 22, Neni 23 dhe Neni 29 (tani KPP Neni 20(1), Neni 22(1)(1.28) dhe Neni 25(3)), dhe Ligjit për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve, Caktimin e Lëndëve tek Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053), Neni 3(3.1) dhe (3.2), Trupi Gjykses i Gjykatës Themelore të Prishtinës (Departamenti i Krimeve të

Rënda) ka juridiksion kompetent për ta gjykuar këtë lëndë (më parë Gjykata e Qarkut e Prishtinës).

21. Në këtë lëndë, akuza kundër të pandehurve është vepra penale e krimit të luftës kundër popullatës civile - Neni 142 i Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, nr. 44/76; prandaj, Gjykata e Qarkut e Prishtinës ka juridiksion lëndor për ta gjykuar lëndën. Sipas Aktakuzës, vepra penale u krye në Llapashticë, që është brenda territorit të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Prandaj, në pajtim me KPPnë, Neni 20(1), Gjykata Themelore e Prishtinës ka juridiksion gjeografik për ta gjykuar këtë lëndë.

22. Meqenëse kjo lëndë u caktua në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it me vendim të Drejtuesit të Njesisë së Lëvizshme të Gjyqtarëve të EULEX-it më datë 28 janar 2013, Trupi Gjykses u përbë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar i Kosovës, në bazë të Ligjit për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve, Caktimin e Lëndëve tek Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë, Neni 3(3.7).

23. Asnjëra palë nuk e kundërshtoi përbërjen e Trupit Gjykses.

24. **Gjendja e luftës / konfliktit të brendshëm të armatosur** – KPRSFJ Neni 142<sup>7</sup> i dënon shkeljet e së drejtës ndërkombëtare (përfshirë Konventat dhe Protokollat e Gjenevës) në 'kohë luftime, konflikti të armatosur ose pushtimi.' Prandaj, si kusht paraprak duhet përcaktuar nëse një gjendje e tillë ekzistonte në kohën materiale të Aktakuzës, konkretisht nga tetori 1998 deri në fund të prillit 1999. Në gjendjen e konfliktit të armatosur të brendshëm, rregullat e zbatueshme janë më të kufizuara se në konfliktin e armatosur ndërkombëtar. Tiparet themelore të konfliktit të armatosur të brendshëm janë:

- a. Se ndërmjet autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura, ose ndërmjet këtyre grupeve brenda një shteti, ndodh dhunë e armatosur e zgjatur,
- b. Se këto grupe janë nën një komandë përgjegjëse, ushtrojnë mbi një pjesë të territorit të shtetit kontroll të tillë që u mundëson të kryejnë

---

<sup>7</sup> KPRSFJ, Neni 142, Krim luftime kundër popullatës civile – Çdo njeri i cili në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në kohë luftime, konflikti të armatosur ose pushtimi, urdhëron që popullata civile të bëhet objekt i vrasjes, torturës, trajtimit çnjerëzor, eksperimenteve biologjike, vuajtjeve të mëdha, ose cenimit të integritetit trupor ose shëndetit; shpërnguljes ose

operacione ushtarake të qëndrueshme dhe të përqendruara dhe të zbatojnë Protokollin II të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe

- c. Se luftimet ndodhin në një nivel që e tejkalon atë që mund të karakterizohet thjesht si trazira dhe tensione të brendshme, të tilla si revolta, akte të izoluara dhe sporadike të dhunës, ose akte të tjera të një natyre të ngjashme.<sup>8</sup>

Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, palët nuk kanë pasur asnjë kontest ose kundërshtim se në kohën materiale të kësaj Aktakuze ekzistonte gjendja e konfliktit të armatosur të brendshëm. Në të vërtetë, dëshmitë e të pandehurve të ndryshëm pohuan pozitivisht se në kohën përkatëse ekzistonte vërtet gjendja e konfliktit të armatosur.<sup>9</sup> Krahas pikëpamjeve të të pandehurve për përfshirjen

zhvendosjes, ose shndërrimit me forcë në një kombësi ose fe tjetër; prostituimit me forcë ose përdhunimit; zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit, marrjes së pengjeve, caktimit të dënimit kolektiv, dërgimit të paligjshëm në kampe përqendrimi, dhe arrestimesh dhe paraburgimesh të tjera të paligjshme, heqjes së të drejtave për shqyrtim gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm; shërbimit të detyruar në forcat e armatosura të ushtrisë armike ose shërbimit të kundërzbulimit ose administratës së saj; punës së detyruar, urisë së popullatës, konfiskimit të pasurisë, plaçkitjes, shkatërrimit të paligjshëm dhe të vetëdëshiruar dhe vjedhjes së pasurisë në shkallë të gjerë, që nuk është e justifikuar me nevojat ushtarake, marrjes së një kontributi ose rekuizimit të paligjshëm dhe shpërpjesëtimor, zhvlerësimit të monedhës vendase ose emetimit të paligjshëm të monedhave, ose i cili kryen ndonjërin nga aktet e mësipërme, dënohet me burgim për jo më pak se pesë vjet, ose me vdekje.

<sup>8</sup> Neni 3 i Përbashkët i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollit II të Konventave të Gjenevës, i vitit 1977, Komentarët e ICRC-së.

<sup>9</sup> Shih deklaratat e secilit prej të pandehurve në shqyrtimin gjyqësor, të përmbledhura më poshtë.

e tyre në konflikt të armatosur, Rezoluta 1199 (1998) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e datës 23 shtator 1998, njeh dhe pranon efektivisht se nga korriku 1998, 'situata në Kosovë përbën një konflikt të armatosur brenda termave të tribunalit [ICTY].' Trupi Gjyqësor nuk ka dyshim se gjendja përkatëse e konfliktit të armatosur të brendshëm vlente në të gjitha kohët materiale për rrethanat e kësaj Aktakuze.

- 25. Pjesëmarrës në konflikt të armatosur & një forcë e organizuar e armatosur** – secili i pandehur pranoi se ishte anëtar pjesëmarrës i UÇK-së i angazhuar aktivisht në detyra të luftës për realizimin e qëllimeve të luftës

të UÇK-së. Në të njëjtën mënyrë, dëshmitë e të pandehurve bëjnë të qartë se në të gjitha kohët materiale, UÇK ishte një strukturë ushtarake e organizuar, me komandë dhe kontroll hierarkik të territoreve gjeografike brenda Kosovës. **R.M.** pranon se kishte qenë xxx i UÇK-së për Zonën e xxx., **L.G.** pranon se kishte qenë xxx i Inteligjencës Ushtarake për Zonën e xxx. dhe **N.M.** pranon se kishte qenë xxx i Policisë Ushtarake për Zonën e xxx..

26. **Lidhja** – për të përbërë krim luftime, aktet e veçanta kriminale nën akuzë duhet të jenë kryer në kuadrin dhe në realizim të objektivave të luftës. Me fjalë të tjera, aktet kriminale të kryera për arsye personale dhe pa asnjë lidhje me ekzistencën e një konflikti të armatosur nuk bëhen krime luftime thjesht për faktin se në atë kohë ekzistonte një konflikt i armatosur. Edhe në këtë rast, vetë të pandehurit e bënë të qartë se paraburgimet dhe marrja në pyetje të civilëve shqiptarë ndodhi vërtet dhe se arsyeja e tyre lidhej me konfliktin, domethënë, sepse ata dyshojnë se ishin bashkëpunëtorë të serbëve, ose se sjellja e tyre ishte e tillë që nuk ishte në dobi të së mirës publike / interesave të shqiptarëve të Kosovës në kohën e luftës. Ndërmjet akteve kriminale që ky Trup Gjyqësor i gjen të provuara, dhe objektivave të luftës të UÇK-së, ekziston një lidhje e qartë.
27. **Statusi i viktimave** – për të gëzuar mbrojtjen e dhënë në një konflikt të armatosur të brendshëm nga Neni 3 i Përbashkët i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Neni 4 i Protokollit Shtesë II, personi nuk duhet të jetë duke marrë pjesë aktive në luftime. Neni 5 i Konventës së Katërt të Gjenevës shpall se ‘kur, në territorin e një Pale në konflikt, kjo e fundit është e bindur se një individ i mbrojtur definitivisht dyshohet ose është përfshirë në veprimtari armiqësore për sigurinë e shtetit, ky person nuk e gëzon të drejtën për t’i kërkuar këto të drejta dhe privilegje sipas kësaj Konvente, të cilat, po të ushtroheshin në dobi të këtij personi të veçantë, do të dëmtonin sigurinë e këtij shteti.’ Megjithatë, në rrethana të tilla, Neni 5 vazhdon të shpallë se ‘Në çdo rast, këta persona do të trajtohen, prapëseprapë, në mënyrë njerëzore, dhe në rast të një procesi gjyqësor, atyre nuk do t’u hiqen të drejtat e procesit të paanshëm dhe të rregullt gjyqësor, të përcaktuara nga kjo Konventë.’ Nën titullin ‘Garancitë Themelore’, Neni 4 i Protokollit Shtesë II parashikon se ‘(1) të gjithë personat të cilët nuk marrin pjesë drejtpërdrejt, ose të cilët nuk marrin më pjesë në luftime, qoftë kur u është kufizuar liria apo jo, gëzojnë të drejtën e respektit për personin e tyre, ... . Në çdo rrethanë ata duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore, pa ndonjë dallim në të kundërtën.’ Dhe ‘(2) pa cenuar aspektin e përgjithshëm të sa më lart, aktet e mëposhtme kundër personave të përmendur në paragrafin (1) janë dhe mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend kudo qoftë: (a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mendore të njerëzve, në veçanti vrasja dhe trajtimi i egër si

tortura, gjymtimi ose çdo formë e ndëshkimit trupor'. Shprehja 'dysohet definitivisht për' në Nenin 5 të KGJ4 duhet kuptuar në mënyrë objektive. Më së paku kjo duhet të kuptojë që, në pamje të parë, ekzistojnë prima facie dëshmi dhe prova reale, që janë të besueshme, që do ta bënë një person të arsyeshëm dhe të paanshëm të arrinte në përfundimin se një person është angazhuar në sjelljen dhe veprimin e ndaluar. Madje edhe kur një person objektivisht përfshihet në atë kategori, prapëseprapë mbeten ndalimet absolute lidhur me keqtrajtimin, të përcaktuara më lart. Megjithëse pretendimi themelor i mbrojtjes në këtë lëndë është se ata që u paraburgosën ishin të gjithë bashkëpunëtorë serbë, dëshmitë dhe provat janë të tilla që Trupi Gjykses nuk e ka të vështirë të arrijë në përfundimin se ky pretendim është nën standardin objektiv të personit të arsyeshëm dhe të paanshëm. Ajo që është paraqitur si dëshmi e bashkëpunimit në çdo rast, nuk është asgjë më shumë veç se thashetheme, fjalë dhe insinuata, shpesh të motivuara, siç duket, nga xhelozia të vogla dhe pa hetim faktik objektiv e të paanshëm as nga policia, as nga autoritetet gjyqësore, për të vërtetuar qoftë faktet mbështetëse bazë. Vetëm shoqërimi në të shkuarën ose të tashmen me serbët mund të ishte i mjaftueshëm për të shpënë në denoncim dhe paraburgim. Në lidhje me viktimat konkrete të dëgjura si dëshmitarë në këtë lëndë, Trupi Gjykses nuk ngurron të arrijë në përfundimin se ata/ato përfshiheshin në kategorinë e 'personave të mbrojtur' sipas Konventave të vitit 1949 dhe Protokolleve Shtesë.

## **PËRMBLEDHJE E DËSHMIVE DHE PROVAVE**

### **28. Dëshmia e L.G.**

- a. Deklaratat e dhëna para Gjyqtarës Hetuese më 28/1/2002, 5/2/2002, 24/6/2002.
- b. Proces-verbalet e shqyrtimit gjyqësor të shkallës së parë, datë 20/02/2003, 21/02/2003, 24/02/2003, 25/02/2003.
- c. Proces-verbali i rishqyrtimit gjyqësor të parë, datë 08/07/2009.
- d. Proces-verbali i rishqyrtimi gjyqësor të dytë, datë 26/03/2013.

29. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e **L.G.** dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmbledhet si më poshtë:

- a. Në thelb, mbrojtja e tij ishte mohim i fakteve të pretenduara, mohim i trajtimit të parregullt të të paraburgosurve, dhe mohim i përgjegjësisë penale.



- b. Nuk ka mëdyshje se **L.G.** pranon se pseudonimi i tij në kohën e luftës ishte '**L**' (shih shënimet personale).
- c. Ai ishte pjesëtar themelues i UÇK-së në Zonën e xxx. Komanda ishte e ndarë në disa sektorë, përfshirë: logjistikën, shëndetin dhe higjienën, financat, mbrojtjen civile, informimin publik, policinë ushtarake, komandantët e brigadave. Shefat e secilit prej këtyre sektorëve ishin pjesëtarë të Këshillit Komandues, i përbërë nga rreth 12 anëtarë, dhe **L.G.** ishte njëri prej tyre. Takimi i parë ishte në 15 ose 16 maj 1998.<sup>8</sup>
- d. Komandant i Zonës së Llapit ishte **R.M.** (i njohur si '**R**'), zëvendës ishte K.K.<sup>9</sup> **N.M.** ishte xxx të policisë ushtarake.<sup>10</sup>
- e. Fillimisht, nga maji 1998 deri në rreth mesin e shtatorit, **L.G.** u përfshi në logjistikë dhe shëndetësi<sup>11</sup>. Rreth nëntorit 1998, **L.G.** u emërua nga Shtabi i Zonës Operative të xxx xxx i Inteligjencës për Zonën e xxx. Ky rol e bëri **L.G.** edhe pjesëtar të Shtabit të Zonës.<sup>12</sup> Me gjithë këtë, **L.G.** mohoi të kishte marrë ndonjëherë pjesë në mbledhjen e informatave të inteligjencës gjatë luftës, sepse ai ishte tepër i zënë me luftime.<sup>13</sup> Ai deklaroi se 'nuk kishte ndonjë organizim të veçantë, secili merrte pjesë në mbledhjen e informatave'.<sup>14</sup>
- f. **L.G.** pranon se Shtabi i Zonës, bashkë me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, i lejonte paraburgimet. Megjithatë, ai mohon të ketë lëshuar ndonjë urdhër për paraburgimin e ndonjë individi, as të ketë marrë pjesë në marrjen e tyre në pyetje ose keqtrajtimin e tyre.<sup>15</sup> Sidoqoftë, ai deklaroi se 'lidhur me çështjen e paraburgimeve, unë pajtohesha me të gjitha vendimet e Shtabit të UÇK-së dhe një prej këtyre vendimeve kishte të bënte edhe me paraburgimin. Unë thashë se Shtabi i Zonës zbatonte vendimet e Shtabit të Përgjithshëm dhe

---

<sup>8</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 3; Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 24/06/2002, f. 3; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/03/2013, f. 5

<sup>9</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 3 & 6; Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 24/06/2002, f. 3

<sup>10</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 6

<sup>11</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/03/2003, f. 11

<sup>12</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 5; Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 24/06/2002, f. 3; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/02/2003 f. 10; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/03/2013, f. 5

<sup>13</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese 26/04/2002, f. 9; Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 24/06/2002, f. 5, f. 9; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 5

<sup>14</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 6

<sup>15</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/02/2003, f. 10; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 2

unë vetë jam pajtuar me këto vendime si pjesëtar i Shtabit.<sup>1617</sup> Ai pranoi se kishte marrë pjesë 2 ose 3 herë në diskutime në takimet në Shtab lidhur me të paraburgosurit.<sup>18</sup>

- g. **L.G.** deklaroi se ishte angazhuar në luftime nga rreth 15 shtatori 1998 deri në 12 qershor 1999.<sup>19</sup> Trupi Gjykses nuk e vlerëson të nevojshme të listojë çdo angazhim në të cilin **L.G.** deklaroi se u përfshi, përveç se ai pohon se nga rreth 24 dhjetori 1998 deri në fund të luftës, ai u përfshi vazhdimisht në luftime në zonën e Tabetit të Llapashticës. Gjatë muajit tetor 1998 deri në fund të prillit 1999, **L.G.** pohon se u përfshi në përgatitjen e transheve, bunkerëve dhe kanaleve të lëvizshme për furnizime në të gjitha vijat e mbrojtjes ndërmjet Majacit dhe Dobrotinit.<sup>20</sup> Ai jep hollësi të mëtejshme lidhur me vendndodhjet dhe veprimtaritë e tij në janar 1999 deri në qershor 1999. Gjatë kësaj pjese të dëshmisë së tij, **L.G.** nuk e përmend Llapashticën.<sup>21</sup>
- h. **L.G.** deklaroi se detyrat e policisë ushtarake përfshinin përgjegjësinë për sigurinë e Zonës, domethënë, sigurinë e Shtabit dhe të komandantit, dhe se ata ishin përgjegjës për komunikimin me çdo person që mund të kishte informacion. **L.G.** deklaroi gjithashtu se ishte policia ushtarake ajo që kishte përgjegjësi për

---

<sup>16</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/02/2003, f. 2; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 2; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor,

<sup>17</sup> /03/2013, f. 5-6

<sup>18</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 6

<sup>19</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 28/01/2002, f. 3

<sup>20</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/02/2012, f. 12

<sup>21</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 21/02/2003, f. 2-12

qendrën e paraburgimit dhe se **N.M.** ishte drejtuesi në detyrë.<sup>22</sup> **L.G.** mohon të kishte ndonjë përgjegjësi komandimi për **N.M.** ose policinë ushtarake.<sup>23</sup> Ai tha se ata 'nuk bënë realisht arrestime, ato ishin biseda informative.'<sup>24</sup> Pastaj **L.G.** e qartësoi këtë si më poshtë: 'para arrestimit, për këtë person ekzistonte informacion, i dhënë nga personi përgjegjës në fshat, dhe pastaj ky informacion i dërgohej komandës së zonës dhe diskutohej. Pastaj, nëse mendohej e nevojshme, Policia Ushtarake e thërriste këtë person për një bisedë informative, që regjistrohej në librin e Policisë Ushtarake, dhe lëshohej një urdhër për kohën që duhej kaluar në burg.' **L.G.** deklaroi gjithashtu se këta persona mund të liroheshin vetëm me urdhra të Komandës<sup>25</sup> dhe se **N.M.** nuk e kishte autoritetin t'i lironte të burgosurit pa lejen e Komandës.<sup>26</sup> **L.G.** deklaroi se ai e takoi **N.M.** në dhjetor 1998 por se ai nuk ishte eprori i **N.M.**<sup>27</sup> Për sa u përket 'bisedave informative', **L.G.** deklaroi më vonë se ky ishte përkthim i gabuar. Ai tha se 'kur personat ishin përfshirë ose vinin tek ne, nuk na takonte neve të bisedonim me ta konkretisht, por se ata ndaloheshin për shkak të veprimtarive të tyre. Qëllimi ynë ishte t'i mbanim ata për aq kohë sa ishte e nevojshme dhe kjo varej nga akuza për rastet individuale.'<sup>28</sup> **L.G.** deklaroi gjithashtu se 'policia ushtarake i merrte ata në pyetje dhe më pas i lironte, por para lirit, ajo konsultoi me komandën e Zonës.'<sup>29</sup> Të paraburgosurit mbaheshin në një shtëpi afër policisë ushtarake në Llapashticë.<sup>30</sup> Kur iu kërkua të qartësonin llojin e personit të paraburgosur, **L.G.** deklaroi 'Dëgjova komandën të thotë se ata ishin një grup i përzierë njerëzish, bashkëpunëtorë serbë, disa hajdutë, disa kishin lënduar serbët'<sup>31</sup> dhe 'njerëzit identifikoheshin dhe paraburgoseshin si rezultat i informacionit nga vendasit të cilët i njihnin mirë ata.'<sup>32</sup> Ai përshkroi gjithashtu llojin e personit të paraburgosur si 'persona të dyshimtë, të cilët dëmtonin interesin e përgjithshëm duke

---

<sup>22</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/03/2013, f. 6

<sup>23</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/03/2013, f. 16

<sup>24</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/01/2002, f. 7

<sup>25</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/02/2002, f. 9-10

<sup>26</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/01/2002, f. 12

<sup>27</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 25/02/2003, f. 3

<sup>28</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 6

<sup>29</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/02/2002, f. 10

<sup>30</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/02/2002, f. 10; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/03/2013, f. 5

<sup>31</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 24/06/2002, f. 8

<sup>32</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 7

bashkëpunuar me armikun, paraburgoseshin dhe në atë mënyrë veprimtaria e tyre do të ndalohej.<sup>33</sup> **L.G.** mohoi që ndonjë person i caktuar të kishte komandë të përgjithshme mbi Qendrën e Paraburgimit dhe deklaroi se ai shkoi atje 2 a 3 herë me vëzhgues ndërkombëtarë. Në raste të tjera, **L.G.** deklaroi se kishte qenë i pranishëm me të paraburgosurit dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë vetëm një herë. Në një rast tjetër, **L.G.** mohoi të kishte hyrë ndonjëherë në objektin e paraburgimit. Ai pohoi se të burgosurit mbaheshin në pajtim me ligjin dhe nën kujdes të duhur. Duhet vënë gjithashtu në dukje se në një moment **L.G.** iu referua qendrës së paraburgimit si 'burg'.<sup>34</sup> **L.G.** deklaroi se të burgosurit ishin të akuzuar me vepra të tilla si vjedhje, kërcenim të familjeve të tjera dhe bashkëpunim me armikun, domethënë, Forcat Serbe.<sup>35</sup> Kur u pyet nëse ai vetë kishte marrë pjesë ndonjëherë në ndonjëherë prej 'bisedave informative' (marrjet në pyetje), **L.G.** deklaroi 'Jo, nuk kam ndenjur gjatë këtyre bisedave por ndodhte me raste kur isha në një takim dhe dëgjoja Oficerin e Policisë kur paraqiste raportet e tij.' **L.G.** mohoi shprehimisht të kishte takuar ose marrë në pyetje ndonjë të paraburgosur <sup>36</sup> dhe mohoi kategorikisht të kishte përdorur ndonjëherë dhunë kundër ndonjë të paraburgosuri.<sup>37</sup><sup>38</sup> Në të vërtetë, eventualisht, **L.G.** pohoi se ekzistonte një vendim i komandës që asnjë i paraburgosur të mos intervistohet kurrë.<sup>39</sup>

- i. **L.G.** pranoi se kishte dijeni për këta të paraburgosur: H.J., A.K. dhe V.J.. **L.G.** deklaroi se ata dyshohej se ishin bashkëpunëtorë por se nuk kishte prova reale kundër tyre, prandaj ata u morën në pyetje dhe u liruan.<sup>40</sup>
- j. **L.G.** mohoi të kishte dëgjuar ndonjëherë për këta të paraburgosur:

---

<sup>33</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 2

<sup>34</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/02/2002, f. 11; Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 24/06/2002, f. 7; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 21/02/2003, f. 6; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 7; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 25/02/2003, f. 2

<sup>35</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/02/2002, f. 13-14; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/03/2013, f. 8

<sup>36</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/02/2002, f. 11; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/03/2013, f. 15

<sup>37</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/02/2002, f. 15; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/02/2003, f. 10; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor,

<sup>38</sup> /03/2013, f. 18

<sup>39</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/03/2013, f. 12

<sup>40</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 28/02/2002, f. 15-16; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 24/02/2003, f. 8

### 30. Dëshmia e N.M.

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 28/01/2002. SHËNIM: **N.M.** pohon se tani ai nuk qëndron pranë përgjigjeve që kishte dhënë gjatë asaj interviste, me pretendimin se në atë kohë kishte pasur dhimbje koke dhe ishte ndjerë nën trysinë e Gjyqtares Hetuese. Prandaj kjo Deklaratë është relevante vetëm për aq sa dha bazën për ballafaqim, bashkë me përgjigjet e dhëna nga **N.M.** në përgjigje të këtij ballafaqimi.
- b. Proces-verbalet e Shqyrtimit Gjyqësor – 25/02/2003, 26/02/2003, 27/02/2003, 10/03/2003, 11/03/2003.
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 9/07/2009 (ose 10/7/2009 – proces-verbali nuk është i qartë përderisa jep dy data).
- d. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor 26/03/2013, 27/03/2013.

31. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e **N.M.** dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmbliidhet si më poshtë:

- a. **N.M.** u kyç në UÇK rreth 1 vit pas formimit të saj,<sup>42</sup> duke e sqaruar më pas datën si 30 tetor 1999,<sup>43</sup> duke u bërë polic ushtarak në tetor 1998. Ai ishte xxx në detyrë (ose xxx) i policisë ushtarake për Zonën e xxx.<sup>44</sup> Ai pranoi se policia ushtarake ishte e veshur me uniforma të zeza. <sup>46</sup> Ai pranon se njihej me pseudonimin **D.** (shih shënimet personale).
- b. Policia ushtarake ishte pjesë e Shërbimit Informativ, dhe **N.M.** pranoi para Gjyqtares Hetuese se ai 'merrte urdhra nga komanda e SHIK-ut' dhe se 'sipas hierarkisë time, unë jepja llogari para

---

<sup>41</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/02/2002, f. 15

<sup>42</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 25/02/2003, f. 6

<sup>43</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/07/2009, f. 3

<sup>44</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 25/02/2003, f. 7; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/07/2009, f. 3; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor,

<sup>45</sup> /03/2013, f. 22

<sup>46</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 9

Proces-

kryetarit të SHIK-ut, **L.G.**. Pseudonimi i tij ishte Komandant **xxxxx**'  
dhe se Komandant **xxxxx** dhe Komandant **xxxxx** i jepnin urdhra

**N.M.**<sup>47</sup> Kjo bie ndesh me ato që **N.M.** deklaroi gjatë shqyrtimit gjyqësor të parë, kur pohoi se ai 'nuk kishte ndonjë autoritet, as de fakto, as de jure'<sup>48</sup> dhe 'kompetencat tona (domethënë, të Policisë Ushtarake) ishin të ndara nga shërbimi informativ dhe unë nuk kisha kontakt me të. Unë merrja urdhra nga komanda dhe jo nga SHIK-u'.<sup>49</sup> Duhet kujtuar se **N.M.** pohoi para Trupit Gjykues të Shqyrtimit Gjyqësor të parë se dallimi në deklarim ishte sepse ai ishte në 'gjendje të keqe' në kohën e intervistës me Gjqqtaren Hetuese. Para Trupit Gjykues të Rishqyrtimit të dytë, **N.M.** deklaroi se kur ishte intervistuar nga Gjqqtarja Hetuese, kishte pasur dhimbje koke dhe gjithashtu se ajo kishte qenë agresive dhe se ai ishte ndjerë nën trysni gjatë intervistës së tij me të. Ai gjithashtu pranoi se kishte qenë prezent me avokatin e tij me përvojë, F.B., gjatë gjithë intervistës dhe se në asnjë fazë as z. B., as vetë **N.M.** nuk shënuan ndonjëherë në proces-verbal gjatë intervistës se ai ndjehej jo mirë, ose se ai ndjehej nën trysni. Gjithashtu **N.M.** iu theksua se me përfundimin e Deklaratës së tij para Gjqqtares Hetuese më 28 janar 2002, në vend që të ankohej për zhvillimin e asaj interviste, përkundrazi, **N.M.** i tha Gjqqtares Hetuese 'E vlerësoj durimin tuaj.'<sup>50</sup> Ky Trup Gjykues e hedh poshtë shpjegimin e tij se ka dhënë dëshmi të gabuar ose të pasaktë për shkak të trysnisë dhe/ose dhimbjes së kokës. Është e qartë se **N.M.** po bënte më të mirën për të dhënë përshkrim të saktë gjatë intervistës para Gjqqtares Hetuese më 28/01/2002, dhe tani ai po përpiqet të tërhiqet nga ai përshkrim, sepse inkriminon veten dhe të bashkëpandehurit e tij. Megjithatë, sepse ai tani pohon se nuk i qëndron asaj interviste, dhe duke marrë parasysh pasojat e Nenit 347(1) të LPP-së, Trupi Gjykues i Rishqyrtimit të dytë, nga ato që u thanë gjatë asaj interviste të vitit 2002, merr parasysh vetëm pjesën ku i pandehuri u ballafaqua shprehimisht me atë deklaratë gjatë shqyrtimit gjyqësor të rishqyrtimit të dytë.

- c. **N.M.** pranoi se pjesë e rolit të tij si xxxx në detyrë i policisë ushtarake, dhe pjesë e rolit të policisë ushtarake ishte të ruante ndërtesat ku mbaheshin të paraburgosurit. Në fakt, policët ushtarakë nën komandën e drejtpërdrejtë të **N.M.** ishin rojet e

---

<sup>47</sup> Deklaratë para Gjqqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 4, Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 9

<sup>48</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 25/02/2003, f. 7

<sup>49</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 9-10

<sup>50</sup> Deklaratë para Gjqqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 18

Proces-

burgut për të paraburgosurit, dhe kjo përfshinte në veçanti në kampin e paraburgimit në Llapashticë.<sup>51</sup>

- d. **N.M.** konsideron se Qendra e Paraburgimit e Llapashticës ishte në funksionim nga nëntori 1998 dhe kishte përfunduar më 24 mars 1999.<sup>52</sup>
- e. **N.M.** i deklaroi Gjyqtares Hetuese në vitin 2002 se zakonisht arrestimet kryheshin nga Ekipet e Mbrojtjes Civile të fshatrave, por se e drejta për të urdhëruar arrestimin i përkiste Komandantit të SHIK-ut (**L.G.**), komandantëve të brigadave, ose komandantit të një Zone.<sup>53</sup> Në shqyrtimin gjyqësor të rishqyrtimit të dytë, **N.M.** mohoi t'i kujtohej kjo gjë, duke pohuar se deklarimi i parë i tij ishte i pambështetshëm për arsyet e treguara më lart. Trupi Gjykues e hedh poshtë atë shpjegim si qenësisht të pabesueshëm dhe të pambështetshëm dhe gjen se deklarimi i parë i tij më 2002 ishte i saktë dhe i mbështetshëm në këtë pikë. <sup>54</sup> **N.M.** mohon kategorikisht që ai ose policët ushtarakë nën kontrollin e tij të kishin urdhërua ose marrë pjesë ndonjëherë në arrestimin e ndonjë personi të përmendur në Aktakuzë. **N.M.** pranon se njerëzit e përmendur u paraburgosën, por pohon se arrestimet fillestare kryheshin nga njësi të tjera. **N.M.** gjithashtu pohon se si polic ushtarak, ai nuk kishte kompetencë të vinte në pikëpyetje vendimet e të tjerëve për arrestime dhe prandaj ai mohoi të kishte pasur ndonjë përgjegjësi komandimi.<sup>55</sup>
- f. **N.M.** gjithashtu i deklaroi Gjyqtares Hetuese në vitin 2002 se në Llapashticë, u intervistuan shumë pak njerëz, por se 'mesa mbaj mend, **L. (L.G.)** intervistoi një herë.'<sup>56</sup> Në vitin 2009 **N.M.** mohoi të kishte ndodhur ndonjë marrje në pyetje nga dikush.<sup>57</sup> Në vitin 2013, ai përsëriti se marrja në pyetje nuk kishte ndodhur asnjëherë.<sup>58</sup> Përsëri, vërehet se **N.M.** mohon që deklarimi i parë i tij është i mbështetshëm, për arsyet e dhëna më lart (d.m.th. trysnia nga Gjyqtarja Hetuese). Ky Trup Gjykues i Rishqyrtimit e hedh poshtë atë mohim dhe vlerëson se deklarimi i vitit 2002 është i saktë dhe i mbështetshëm. Në raste të tjera ai ka deklaruar se të paraburgosurit

---

<sup>51</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/03/2013

<sup>52</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 10

<sup>53</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese 28/01/2002, f. 4

<sup>54</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 4

<sup>55</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/02/2003, f. 2

<sup>56</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 5

<sup>57</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor 10/07/2009, f. 8,

<sup>58</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/03/2013, f. 23, pp30-31

Proces-



nuk u intervistuan kurrë në Llapashticë, as u dërguan gjëkund për intervistë.<sup>59</sup> **N.M.** konsideroi se ishte befasuese as nuk ndodhi asnjë intervistim. **N.M.** e dinte se të paraburgosurit ishin paraburgosur me akuza të përgjithshme dhe për bashkëpunim me armikun.<sup>60</sup>

- g. Lidhur me Akuzën konkrete në fjalë në këtë rishqyrtim gjyqësor të dytë, domethënë, Akuza 8 nga Aktakuza e Përmirësuar e vitit 2003, **N.M.** mohon çdo përgjegjësi penale. Ai pohon se asnjë dëshmitar, përveç Dëshmitarit Anonim 7, nuk jep prova të rrahjes dhe torturës. Ai pohon se asnjë person i cekur me emër në Akuzën 8 nuk u arrestua nga **N.M.** ose ndonjë polic ushtarak nën komandën e tij. As **N.M.**, as policët ushtarakë nën komandën e tij nuk kishin dijeni për arsyet e arrestimit dhe paraburgimit, përveç se ajo kishte lidhje me 'bashkëpunimin me armikun' dhe ai mohoi posaçërisht që ai, ose policët ushtarakë në komandën e tij të jenë përfshirë në rrahje ose torturë ose marrje në pyetje të të burgosurve.<sup>61</sup> **N.M.** pohoi se ai e drejtonte njësinë e tij me disiplinë të rreptë ushtarake. **N.M.** deklaroi se ai 'nu ka dijeni personale se ndokush është torturuar në Qendrën e Paraburgimit të Llapashticës'<sup>62</sup>, as mori nga të paraburgosurit ndonjë ankesë për rrahje para se të vinin në Llapashticë.<sup>63</sup> **N.M.** konfirmon se ai e ndaloi torturën. Ai tha se e kishte bërë këtë jo për shkak të ndonjë problemi dhe atë vetëm një ushtar e pati pyetur njëherë nëse mund të qëllonte me pëllëmbë në fytyrë një të paraburgosur por ai, **N.M.**, i kishte thënë se kjo nuk lejohej.<sup>64</sup> Po kështu, në shqyrtimin gjyqësor më 27/03/2013, Prokurori e ballafaqoi **N.M.** me përgjigjen që ai i kishte dhënë Gjyqtares Hetuese: 'Unë e ndalova torturën, çka më krijoi disa probleme. Unë ua ndalova ushtarëve të hynin pa lejen time. ... Kjo nuk vlente për SHIK-un, sepse ata ishin eprorët e mi.'<sup>65</sup> Kur u kundërshtua nga Kryetari i Trupit Gjyqësor se në vitin 2002 **N.M.** i kishte dhënë Gjyqtares Hetuese shpjegim të hollësishëm e të gjithanshëm lidhur me nevojën për të ndaluar torturën dhe vështirësitë që kjo i kishte shkaktuar **N.M.** si pasojë, nëse ai

---

<sup>59</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 10

<sup>60</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 10

<sup>61</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 10/07/2009, f. 3

<sup>62</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 5

<sup>63</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 27/02/2003, f. 3

<sup>64</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 26/02/2003, f. 11

<sup>65</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2002, f. 6

Proces-  
Proces-  
Proces-

përshkrim i hollësishëm do të kishte qenë ose gabim, ose i pavërtetë, atëherë si mund të shpjegohej ai gabim me 'trysninë' ose 'dhimbjen e kokës', **N.M.** u përgjigj se 'Nuk kam përgjigje për këtë pyetje.'<sup>66</sup> **N.M.** mohon të ketë ekzistuar ndonjë rregull që të paraburgosurit duhej të qëndronin në këmbë dhe me fytyrë nga muri kur eprorët të hynin në dhomë, megjithëse ai pranoi se duhej të rrinin në këmbë për t'i numëruar.<sup>67</sup>

- h. **N.M.** konfirmoi praninë e të paraburgosurve të quajtur D.B. dhe **A.M.** në Qendrën e Paraburgimit të Llapashticës.<sup>68</sup>
- i. Dhoma e paraburgimit në Llapashticë mbante maksimumi 10 deri në 12 vetë.<sup>69</sup>
- j. Vëzhguesit ndërkombëtarë e kishin vizituar dy herë Qendrën e Paraburgimit për të këqyrur shëndetin dhe mirëqenien e të paraburgosurve.<sup>70</sup>
- k. Nuk kishte pasur incidente ku të ishte dashur të ndaleshin përleshjet ndërmjet të paraburgosurve.<sup>71</sup>
- l. **N.M.** deklaroi se askush nuk u ankua ndonjëherë për paraburgimin e tyre.<sup>72</sup>

## 32. Dëshmia e R.M.

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 13/08/2002
  - i. SHËNIM: Kjo Deklaratë u shpall e papranueshme dhe nuk u mor parasysh nga Trupi Gjyqësor në marrjen e aktgjykimit të tij. Shih Paragrafi 10 më lart.
- b. Proces-verbalet e Shqyrtimit Gjyqësor më 14/03/2003, 17/03/2003, 18/03/2003.
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 09/07/2009 (ose ndoshta 10/07/2008, proces-verbali i parë nuk është i qartë pasi i jep të dy data).
- d. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 27/03/2013.

---

<sup>66</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 27/03/2013, f. 3

<sup>67</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 27/02/2003, f. 3

<sup>68</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 26/02/2003, f. 11; Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 28/01/2012, f. 14

<sup>69</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 27/02/2003, f. 3; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/07/2009, f. 4

<sup>70</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 27/02/2003, f. 3

<sup>71</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 27/02/2003, f. 4

<sup>72</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/07/2009, f. 12

Proces-

33. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e **R.M.** dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. **R.M.** konfirmoi se pseudonimi i tij gjatë luftës ishte **xxxxx** (shih shënimet personale). **R.M.** pranoi se kishte qenë xxx i UÇK-së për rajonin e Llapashticës<sup>7374</sup> nga fillimi i shtatorit 1997<sup>75</sup> dhe se ishte përgjegjës për veprimet e atyre nën komandën e tij.<sup>76</sup> **R.M.** deklaroi se **L.G.** dhe **N.M.** i raportonin drejtpërdrejt Shtabit. **L.G.** ishte më lart se **R.M.**, sepse **L.G.** ishte pjesëtar i Komandës. **R.M.**, xxx i tij dhe xxx i tij i Shtabit të gjithë kishin komandë mbi **R.M.**.<sup>77</sup> **R.M.** e mohon mbajtjen e përgjegjësisë personale ose të komandimit për ndonjë rrëmbim, paraburgim të paligjshëm, rrahje ose torturim të civilëve shqiptarë, dhe, për rrjedhojë, mohon të kenë ndodhur incidente të tilla ndonjëherë.<sup>78</sup> **R.M.** deklaroi se ekzistonte një vendim i përgjithshëm nga ai vetë dhe Shtabi i Zonës së Llapit për të urdhëruar paraburgimin e individëve të caktuar në Llapashticë. Kjo ishte për arsye ushtarake, sepse njerëzit e paraburgosur pretendoheshin të ishin 'kolonë e pestë / bashkëpunëtorë'.<sup>79</sup>
- b. Vendimi për të arrestuar/ paraburgosur u zbatua nga shërbimet që 'ne krijuam, policia ushtarake, brigadat, mbrojtja civile dhe njësi të tjera.' Shumica e të paraburgosurve u sollën nga grupet mbështetëse, gjithashtu nga policia ushtarake ose njësi të tjera brigade. Në shumë raste ata (të akuzuarit si bashkëpunëtorë) paraqiteshin vetë. **R.M.** pohon se numri total i të paraburgosurve ishte shumë i vogël.<sup>80</sup> Vendimet individuale se kush duhej paraburgosur mund të merreshin në nivel të Shtabit, në nivel brigade, ose edhe komandantët e njësive më të ulëta mund të jepnin urdhra gojorë për paraburgosje. 'Ne i ndërmorëm veprimet tona

---

<sup>73</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 14/03/2003, f. 5, f. 6; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 09/07/2009, f. 16; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, <sup>74</sup> /03/2013, f. 7

<sup>75</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 14/03/2003, f. 7

<sup>76</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 27/03/2013, f. 10

<sup>77</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 4

<sup>78</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 14/03/2003, f. 6

<sup>79</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 14/03/2003, f. 6, f. 9; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 09/07/2009, f. 16-17

<sup>80</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor 14/03/2003, f. 8

Proces-  
Proces-  
Proces-

para se të mund të vepronin vetë bashkëpunëtorët, por ne jemi të sigurt se ata do të vepronin (d.m.th. **R.M.** pranon se bashkëpunëtorët e pretenduar mund të arrestoheshin nga UÇK para se ata të kishin kryer faktikisht ndonjë akt bashkëpunimi. Kësisoj, duhet arritur në përfundimin se thashethemet dhe insinuatat mund të ishin të mjaftueshme për të rezultuar në paraburgimin e një personi.) **R.M.** gjithashtu pranon se 'ne nuk ishim të gjendje të organizonim me efektivitet një sistem për të zbuluar se çfarë po bënin ata'. Kur iu kërkua ta sqaronte këtë, **R.M.**

u përgjigj 'ne e dinim se ishte e vështirë të siguroje informacion, sepse ai nuk sigurohej kurrë lehtë nga njerëzit. Për këta njerëz zhvilloheshin seanca dëgjimore, por ato nuk ishin të efektshme', që më pas **R.M.** e modifikoi duke thënë 'nuk ekzistonte një sistem i tillë për marrjen në pyetje, por marrja në pyetje ndodhi'. Megjithatë **R.M.** pohoi më pas se 'parimi i përgjithshëm ishte që njerëzit të mos merreshin në pyetje, sepse ne nuk ishim në gjendje ta organizonim këtë gjatë asaj periudhe.'<sup>8182</sup>

- c. **R.M.** pranon se në Llapashticë ekzistonte një qendër paraburgimi.<sup>83</sup> Qendra e Paraburgimit ishte afër Shtabit të Zonës, 100 metra deri në 200 metra më tutje.<sup>84</sup> Ishte puna e policisë ushtarake t'i siguronte të paraburgosurit. Por, **R.M.** pranon se 'Unë e mbajta veten të informuar për të paraburgosurit, por nuk isha gjithnjë i informuar për çdo gjë'. **N.M.** ishte xxx i Policisë Ushtarake në Zonën e xxx, rol që ia kishte caktuar **R.M.**<sup>85</sup> Detyra e **R.M.** ishte t'i raportonte Shtabit për të paraburgosurit. **R.M.** mohon të ketë hyrë ndonjëherë në qendrën e paraburgimit në Llapashticë.<sup>86</sup> **R.M.** deklaroi se ai i lejonte vizitat nga organizata ndërkombëtare në qendrën e paraburgimit, por nuk e di nëse vizita të tilla ndodhën në fakt.<sup>87</sup> **R.M.**

---

<sup>81</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 14/03/2003, f. 10; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 09/07/2009, f. 23-24; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor /03/2013, f. 10, f. 12

<sup>83</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 14/03/2003, f. 8, f. 9

<sup>84</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 14/03/2003, f. 10; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 09/07/2009, f. 18; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 27/03/2013, f. 8

<sup>85</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 09/07/2009, f. 21; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 27/03/2013, f. 8

<sup>86</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 14/03/2003, f. 9; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 09/07/2009, f. 26

<sup>87</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 2

Proces-

pranon se si komandant i zonës, ai ishte përgjegjësi kryesor për të paraburgosurit nën kontrollin dhe kujdesin e Zonës.<sup>88</sup>

- d. **R.M.** pohon se kur mbajtja e Llapashticës u bë e pamundur për shkak të veprimit ushtarak serb, ai/Shtabi urdhëroi lirimin e të gjithë të paraburgosurve. Ai mohoi të kishte dijeni për vdekjen e ndonjë të paraburgosuri.<sup>89</sup> Po kështu, **R.M.** pranoi se 'i mora personalisht vendimet për lirim ose vazhdim të paraburgimit të ndokujt, bazuar në referencat e vartësve të mi.' Ai vazhdoi të sqaronte se kjo do të thoshte 'Shefi im i Shtabit ose zëvendësi im. Ata kishin informacionin relevant, por unë nuk e di se nga ku.'<sup>90</sup>
- e. **R.M.** deklaroi se **L.G.** ishte emëruar shef i shërbimit informativ për Zonën dhe se puna e tij ishte të zbulonte kërcënimet e mundshme ndaj ushtrisë dhe popullit. **R.M.** e emëroi **L.G.** në atë rol. **R.M.** pohoi se bashkëpunëtorët nuk kishin informacion të rëndësishëm lidhur me armikun.<sup>91</sup> **R.M.** nuk e shpjegoi si kishte ndodhur që ai ose vartësit e tij e dinin se të paraburgosurit nuk kishin informacion relevant. Trupi Gjyqësor vlerëson se të paktën një metodë për të mësuar me siguri se të paraburgosurit nuk kishin informacion relevant, është të merreshin të paraburgosurit në pyetje. Në të njëjtën mënyrë, në përcaktimin se cilët të paraburgosur ishin të sigurt për lirim dhe për cilët nevojitej paraburgim i mëtutjeshëm, Trupi Gjyqësor arrin në përfundimin se vendime të tilla të dukshme nuk mund të merreshin pa ndonjë masë të marrjes në pyetje.
- f. **R.M.** konfirmoi se policia ushtarake vishte uniforma të zeza.<sup>93</sup>
- g. **R.M.** konfirmon se ai dha 3 amnisti.<sup>94</sup> **R.M.** iu kujtua një rast kur të paraburgosurit ishin liruar dhe pastaj ishin arrestuar sërish. Arsyeja për këtë është se lirimi kishte qenë i paautorizuar dhe se ata nuk duhej të ishin liruar fare.<sup>95</sup> Nga këto pohime kuptohet se kontrolli i fundit i lirimeve në Llapashticë ishte në varësi të kontrollit dhe vendim-marrjes së përgjithshme të **R.M.**

---

<sup>88</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 27/03/2013, f. 10

<sup>89</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 14/03/2003, f. 8-9

<sup>90</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 14/03/2003, f. 10

<sup>91</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 14/03/2003, f. 10; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 09/07/2009, f. 20-21; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor,

<sup>92</sup> /03/2013, f. 8

<sup>93</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 3

<sup>94</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 3

<sup>95</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 4

Proces-  
Proces-  
Proces-

- h. **R.M.** mohoi të kishte dijeni për ndonjë keqtrajtim të ndodhur dhe mohoi që ai personalisht të kishte keqtrajtuar ndonjë person ndonjëherë.<sup>96</sup>
- i. **R.M.** pohoi se vizitat familjare për të paraburgosurit lejoheshin.<sup>97</sup>
- j. **R.M.** konfirmoi se ishte në dijeni të arrestimit të A.K., A.M., D.B.,<sup>98</sup> I.S., E.S.<sup>99</sup> Ai ishte gjithashtu në dijeni se A.M. ishte liruar dhe ishte arrestuar sërish nga ushtarë të UÇK-së.<sup>100</sup>

---

<sup>96</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 6, Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 18/03/2003, f. 2

<sup>97</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 5

<sup>98</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 13/08/2002, f. 12

<sup>99</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 5

<sup>100</sup> verbal i shqyrtimit gjyqësor, 17/03/2003, f. 5

Proces-

#### 34. Dëshmia e Dëshmitarit Anonim 7 (R.B. hoqi dorë nga anonimiteti)

- a. Deklarata dhënë policëve hetues më 20/08/2002 – shih Aktvendimin në paragrafin 6 më lart: kjo Deklaratë nuk është shqyrtuar nga Trupi Gjykes në arritjen e përfundimit të tij, as është shqyrtuar ndonjë pyetje ose përgjigje bazuar në atë Deklaratë.
- b. Deklarata para Gjyqtars Hetuese më 23/08/2002
- c. Proces-verbalet e Shqyrtimit Gjyqësor më 31/03/2003, 1/04/2003.
- d. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 15/09/2009.
- e. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 4/04/2013.

35. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e R.B. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmbliidhet si më poshtë:

- a. Më ose rreth datave 25 ose 26 nëntor 1998, R.B. po udhëtonte nga Prishtina për në Podujevë, kur ai u ndalua nga 3-5 pjesëtarë të UÇK-së me uniformë dhe të armatosur në fshatin **xxxxx**. Ata e pyetën për emrin, bashkë me emrin e personit me të cilin po udhëtonte, dhe pastaj ai u informua nga pjesëtarët e UÇK-së se kishin marrë urdhra për t'i arrestuar. Pjesëtarët e UÇK-së ishin S.S., I.M. dhe S. Ata kishin veshur uniformë ushtarake. Atë e dërguan me veturë me thes mbi kokë në Llapashticë, ku mbërritën rreth datës 25 ose 26 nëntor 1998. Atë natë fjeti në një stallë ku mbaheshin edhe 7 deri në 8 të paraburgosur të tjerë.<sup>101</sup>
- b. Të nesërmen në mëngjes, R.B. e dërguan në një ndërtesë 20-30 metra më tutje për marrje në pyetje. Ndërtesa ishte një shtëpi me 3 ose 4 dhoma. Me thes mbi kokë, R.B. u shoqërua për në ndërtesë nga rojet. Ai kujton se e dërguan në këtë ndërtesë tre herë. Gjatë marrjes në pyetje për herë të parë, atij i thanë 'Ti je spiun. Përse shoqërohesh me serbët? Përse kalon kohë me ta?' Marrja në pyetje për herë të parë zgjati rreth 2 orë dhe ai nuk ishte kërcënuar, as keqtrajtuar gjatë kësaj marrjeje në pyetje. Ai nuk arriti të njihnte se kush e mori në pyetje gjatë këtij rasti të parë. Më pas atë e kthyen në stallë. Atij nuk i treguan se për sa kohë do të mbahej i paraburgosur.<sup>102</sup>

---

<sup>101</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 2-3; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 31/03/2003, f. 2-3,

<sup>102</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 5-6

- c. R.B. u mor në pyetje për herë të dytë rreth një javë pas herës së parë. Përsëri atë e dërguan nga stalla me thes mbi kokë. Gjatë gjithë intervistës atë e detyruan të mbante thesin në kokë. Megjithëse e kishte kokën të mbuluar me thes, R.B. arriti që gjatë marrje në pyetje ta largonte thesin nga sytë herë pas here, për të parë kush po e sulmonte. Ai pa **L.G.** dhe **N.M.**. Ata kishin veshur uniforma, **L.G.** kishte veshur uniformë ushtarake kamuflazhi, kurse **N.M.** kishte veshur uniformë të zezë.<sup>103</sup> Në marrjen në pyetje për herë të dytë, '**L.G.** më intervistoi dhe **N.M.** më rrahu.'<sup>104</sup> Duhet vërejtur se, për të mësuar identitetin e personave marrës në pyetje, R.B. është i varur nga ajo që i treguan të paraburgosurit e tjerë, megjithëse ai pretendon se dalloi edhe zërat. Ai gjithashtu deklaroi se i njihte ata vetëm nga pseudonimet e tyre, por pas luftës ua kishte mësuar emrat e vërtetë.<sup>105</sup> Ai u mor në pyetje nga '**xxxxx**' i cili, siç arriti të mësonte, quhej **L.G.** dhe ishte xxx, dhe nga '**xxxxx**' i cili, siç arriti të mësonte, quhej **N.M.** dhe ishte xxxx.<sup>106</sup> R.B. beson se personat që e morën në pyetje në intervistën e dytë ishin të njëjtit persona që e kishin marrë në pyetje në intervistën e parë.<sup>107</sup> Ata i bënë të njëjtat pyetje si në rastin e parë të marrjes në pyetje dhe i kërkuan të pranonte gjëra që ai nuk i kishte pranuar. Pikërisht gjatë intervistës së dytë ata nisën ta rrahin.<sup>108</sup>
- d. R.B. deklaroi se në dhomë ishin dy persona, kurse roja që e kishte shoqëruar nga stalla qëndroi jashtë dhomës. Ai deklaroi se ai që e rrahu ishte **N.M.**, kurse ai që e mori në pyetje ishte **L.G.**. Rrahja bëhej duke përdorur një shkop dhe një 'shkop elektrik' (shkop bagëtish) dhe zgjati rreth 1 orë para se të bëhej një pushim prej 30 minutash dhe pastaj vazhdohej. Megjithëse e detyruan ta mbante kokën të mbuluar me thes gjatë gjithë kohës, ai arriti të shihte nën thes, teksa kruante kokën, për të parë kush po e rrihte dhe merrte në pyetje. R.B. e rrahën duke e goditur në këmbë, krahë dhe shpinë, ndërkohë që ishte i ulur. Shkopi elektrik u përdor për një kohë të gjatë në qafën dhe gjunjët e tij, duke i shkaktuar humbje të ndjenjave dhe dridhje. Kjo ishte tejet e dhimbshme. Në total, kjo u duk se zgjati rreth 3 orë.<sup>109</sup> R.B. deklaroi se ai nuk e kuptoi kurrë vërtetë përse, ose çfarë donin prej tij. Si pasojë e rrahjes, R.B. deklaroi se u mbulua në

---

<sup>103</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 9

<sup>104</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 6-7

<sup>105</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 7 rreshtat 10-15

<sup>106</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 4

<sup>107</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 7 rreshtat 19-21

<sup>108</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 7

<sup>109</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 23/08/2002, f. 10



mahisje dhe në vitin 2002 pretendoi se ende vuante nga shpina. Pas asaj rrahjeje, ai nuk ishte në gjendje të ecte pa ndihmë dhe në kthim për në stallë u ndihmua nga roja.<sup>110</sup>

- e. R.B. u lirua më 31 dhjetor 1998. Dy ditë para kësaj, ai u mor në pyetje për herë të tretë. Përsëri atij i bënë të njëjtat pyetje. Në këtë rast kokën nuk ia kishte mbuluar me thes dhe ishte **L.** dhe **N.M.** ata që e bënë marrjen në pyetje. R.B. është i sigurt se këta ishin të njëjtit persona të cilët e kishin marrë në pyetje më parë. Marrja në pyetje zgjati më pak se një orë dhe atë e rrahën. Ishte **N.M.** ai që e rrahu me shkop në të gjithë trupin dhe rrahja zgjati 15 minuta pa pushim. R.B. e përshkroi **N.M.** si person që ishte jashtë kontrollit. **L.** merrte në pyetje, ndërsa **N.M.** rrihte. Si pasojë, R.B. nuk mundi të ecte për një ditë dhe nuk mundi të qëndronte në këmbë deri në ditën që u lirua.<sup>111</sup>
- f. Në lirim e tij, R.B. iu dha një letër nga **N.M.** dhe të nënshkruar prej tij, në të cilën ai akuzohej se ishte bashkëpunëtor armik, pa ndonjë justifikim ose arsyetim.<sup>112</sup>
- g. Gjithë-gjithë, R.B. u mbajt në paraburgim për rreth 37 ditë, me rreth 7-10 të paraburgosur të tjerë në stallë, gjatë së cilës kohe ai u mor në pyetje 3 herë dhe u rrah dy herë. Të paraburgosurit e tjerë përfshinin H.H., I.S., A.T.M., N.H., M., A.X. dhe dy vëllezër emrat e të cilëve R.B. nuk i dinte. R.B. konfirmon se edhe këta të paraburgosur të tjerë u rrahën. Ndonjëherë rrahjet bëheshin edhe brenda në stallë nga ushtarë të tjerë të UÇK-së, dhe në disa raste të paraburgosurit i detyruan të rrahin njëri-tjetrin.<sup>113</sup>
- h. Me gjithë dëshminë e hollësishme të dhënë para Gjyqtarës Hetuese rreth ngjarjeve në Llapashticë, në veçanti se në të 3 rastet kur ai ishte marrë në pyetje nga '**xxxxx**' (**L.G.**) dhe '**xxxxx**' (**N.M.**) dhe në dy rastet e fundit kur ai ishte rrahur fort nga **N.M.**, ndërsa **L.G.** i bënte pyetje, në shqyrtimin gjyqësor në vitin 2003, R.B. mohoi ta kishin rrahur ndonjëherë, madje edhe ta kishin marrë ndonjëherë në pyetje, përveç natës së parë të paraburgimit. Kur u pyet përse ai kishte deklaruar të kundërtën më parë, R.B. thjesht mohoi t'i kishte deklaruar ato gjëra para Gjyqtarës Hetuese. Më vonë ai pohoi se deklarimi që kishte bërë para Gjyqtarës Hetuese 'm'u imponua nga Policia dhe Prokurori Publik', domethënë që 'mua më mësoi të flas në atë mënyrë Policia dhe Prokurori' dhe 'mua më mësuam të them

---

<sup>110</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 23/08/2002, f. 11

<sup>111</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 23/08/2002, f. 7, pp11-13; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 31/03/2003, f. 3 (data e referencës e lirit)

<sup>112</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 23/08/2002, f. 13-14

<sup>113</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 23/08/2002, f. 16-19

se isha marrë në pyetje nga **L.G.** dhe se **N.M.** më kishte rrahur.’<sup>114</sup> Shpjegimet e mundshme për dallimet thelbësore ndërmjet dy deklarimeve krejtësisht të kundërta janë si më poshtë: i/ zbardhja e nënshkruar e deklaratave para Gjyqtares Hetuese ishte e trilluar, në kuptimin që Gjyqtarja Hetuese thjesht krijoi një proces-verbal të rremë, ose ii/ kishte gabime të jashtëzakonshme në përkthim, deri në atë shkallë sa që krijonte një përkthim të hollësishëm që në fakt ishte i rremë, ose iii/ në vitin 2002 R.B. dha para Gjyqtares Hetuese deklaratën që u tregua, por ajo deklaratë ishte e pavërtetë, ose iv/ deklarata e tij para Trupit Gjykues të Shqyrtimit Gjyqësor në vitin 2003 duhej të ishte gënjeshtër. Këtu nuk ka vend për të thënë se të dyja deklaratat janë të sakta, domethënë, versioni para Gjyqtares Hetuese dhe deklarimi para Trupit Gjykues Shqyrtimit Gjyqësor të parë dhe Trupit Gjykues të Shqyrtimit Gjyqësor të mëvonshëm,<sup>115</sup>

- i. Në rishqyrtimin e parë gjyqësor të vitit 2009, R.B. konfirmoi faktin e paraburgimit të tij ndërmjet datave 27 ose 28 nëntor 1998 dhe 31 dhjetor 1998, dhe se natën e parë ai ishte marrë në pyetje nga **N.M.** dhe **xxxxx**.<sup>116</sup> Ai mohoi të ishte rrahur në mënyrat e hollësishme që kishte përshkruar para Gjyqtares Hetuese, dhe duket se sugjeroi se aty ku proces-verbali kishte shënuar se ai ishte rrahur, ky ishte një keqkuptim. Në vend të kësaj, ai u ankua se kishte qenë ftohtë dhe nuk kishte pasur ngrohje.<sup>117</sup> Më pas, në mënyrë disi kontradiktore, ai pohoi se i kishte treguar të vërtetën Gjyqtares Hetuese.<sup>118</sup><sup>119</sup>
- j. Në rishqyrtimin e dytë gjyqësor në vitin 2013, pas një pasazhi ngatërrues kur nuk ishte e qartë nëse dëshmitari e pranonte apo e refuzonte deklaratën e mëparshme të tij para Gjyqtares Hetuese, Trupi Gjykues mban qëndrimin se ai në thelb qëndroi pranë deklaratimit të tij para Trupave Gjykuese të parë dhe të dytë, por jo pranë përkthimit të tij para Gjyqtares Hetuese. Nga ana e Prokurorit u bë një proces i thellë ballafaqimi i dëshmitarit me deklaratat e mëparshme kontradiktore të tij. R.B. vërtet konfirmoi se ishte marrë në pyetje nga **N.M.**, të cilin e njohte si ‘**xxxxx**’, por mohoi ta kishte parë **L.G.**, të cilin e njohte si ‘**xxxxx**’, duke deklaruar

---

<sup>114</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 1/04/2003, f. 2

<sup>115</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 31/03/2003, f. 3-4

<sup>116</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/09/2009, f. 31

<sup>117</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/09/2009, f. 32

<sup>118</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/09/2009, f. 33

<sup>119</sup> /04/2013, f. 27

Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor,

se 'mua më thanë se ai ishte atje, por unë nuk e di, sepse e kisha kokën të mbuluar me thes.<sup>115</sup> R.B. vërtet konfirmoi se **N.M.** e mori në pyetje dhe e akuzoi se ishte bashkëpunëtor serb.<sup>120</sup> Ai përsëri mohoi të kishte ndodhur ndonjë rrahje në Llapashticë.<sup>121</sup> Ai tha se referencat lidhur me rrahjet kishin qenë keqinterpretime të ankesave për motin.<sup>122</sup> Ai pohoi se përshkrimi që kishte bërë para Gjyqtarës Hetuese ishte i pavërtetë dhe/ose i pasaktë dhe në mënyra të ndryshme ai ua vinte fajin gabimeve në përkthim,<sup>123124</sup> apo se ai ishte vënë nën trysni nga Policia dhe/ose Gjyqtarja e UNMIKut dhe se i ishte ofruar kandisje për ta dërguar në një vend tjetër.<sup>120</sup>

- k. Këtu nuk është e nevojshme të përsërisim procesin e ballafaqimit. Mjafton të thuhet se dëshmitarit iu dha çdo mundësi për t'i shpjeguar këto mospërputhje dhe për të verifikuar besueshmërinë e tij. Trupi Gjykues arrin në përfundimet e mëposhtme. Përshkrimi i R.B. para Trupave Gjykuese të Shqyrtimeve Gjyqësore në vitet 2003, 2009 dhe 2013, në të cilat ai mohon të ketë ndodhur ndonjë trajtim i parregullt, rrahje ose torturë në Qendrën e Paraburgimit në Llapashticë, është dukshëm i rremë. Edhe në vitin 2013, R.B. vërtet konfirmoi se ishte paraburgosur kundër vullnetit të tij nga ushtarët e UÇK-së dhe ishte dërguar në Qendrën e Paraburgimit të Llapashticës. Ai konfirmoi më së paku se ishte marrë në pyetje natën e parë nga **N.M.**, i cili e akuzoi R.B. se ishte bashkëpunëtor serb. Ai pranon se e njohte **N.M.** me pseudonimin 'D.', një pseudonim që **N.M.** pranon se e ka përdorur. R.B. konfirmon më së paku se të tjerë i kishin treguar atij se **L.G.** ishte prezent dhe përdorte pseudonimin 'xxxxx', pseudonim që **L.G.** pranon se e ka përdorur. Për atë që R.B. përpiket ta mohojë të vërtetën e përshkrimit të tij të dhënë para Gjyqtarës Hetuese, shpjegimet prej tij të mospërputhjeve janë thjesht absurde dhe e pamundur të besohen. Edhe sikur të lësh vend për gabime përkthimi, nuk është e mundur të arrihet deri në një përshkrim kaq të afërt dhe të hollësishëm të ngjarjeve, njerëzve, veshjeve, fjalëve të thëna dhe rrahjeve e lëndimeve, në rast se të gjitha këto çështje do të ishin të pasakta dhe të pavërteta, thjesht për arsye të gabimeve të përkthimit. Një sugjerim i tillë është absurd. Propozimi alternativ është se R.B. gënjeu qëllimisht si pasojë e

---

<sup>120</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 4/04/2013, f. 29

<sup>121</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 4/04/2013, f. 12, f. 29-30

<sup>122</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 4/04/2013, f. 13-14

<sup>123</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 4/04/2013, f. 12

<sup>124</sup> /04/2013, f. 20-21, f. 33

Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor,

trypsisë dhe/ose kandisjes nga Policia e UNMIK-ut, prokurorët ose gjyqtarët. Së pari, ne vlerësojmë se nuk janë bërë kandisje të paligjshme. Së dyti, e vetmja referencë për ndonjë kandisje faktike është mundësia e rivendosjes së tij. Meqenëse R.B. ishte dëshmitar anonim në atë kohë, është krejt e mundur që të jetë bërë fjalë për mundësinë e rivendosjes së R.B. në një vend tjetër. Një koment i tillë është krejtësisht i rregullt dhe i përligjur dhe nuk është aspak kandisje e parregullt, dhe thjesht nuk mund të arrijë deri në trypsi për të dhënë deklaram të rremë. Mundësia e tretë është që Gjyqtarja Hetuese lejoi që të krijohet një proces-verbal kryekëput i parregullt, i pavërtetë, plot gënjeshtër dhe të pavërtetë, që nuk u deklaruan kurrë nga dëshmitari. Kjo është thjesht marrëzi. Kjo do të kërkonte një komplot ndërmjet Gjyqtarës, Prokurorit, procesmbajtësve dhe përkthyesve të gjykatës. Sido që të jetë, Mbrojtësi ishte i pranishëm në intervistën tek Gjyqtarja Hetuese dhe, po të ishte krijuar një proces-verbal i tillë i rremë, Mbrojtësi do t'i kishte shënuar menjëherë kundërshtimet e veta në proces-verbal. I vetmi shpjegim i mundshëm i deklarimit të bërë nga R.B. para Gjyqtarës Hetuese, me hollësitë themelore të tij, është se ai deklarim është i vërtetë dhe ky është edhe konstatimi i Trupit Gjykues. Për më tepër, dëshmia që dha R.B. në deklarimin e parë të tij, vërtetohet nga deklaramet e dëshmitarëve të tjerë, të cilat Trupi Gjykues i pranon si të vërtetë. Prandaj faktet e përcaktuara në paragrafët 35(a) deri në (g) më lart gjenden të provuara.

**36. Dëshmia e Dëshmitarit I (Shënim: Dëshmitari I është dëshmitar i mbrojtur dhe JO Dëshmitar Anonim, pasi identiteti dhe shënimet personale të tij u morën në gjykatë në prani të palëve dhe mbrojtësve të tyre)**

- a. Deklarata para Gjyqtarës Hetuese më 20/02/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 20/06/2003
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 23/06/2003
- d. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 11/04/2013

37. Në shqyrtimin gjyqësor të datës 11/04/2013, Dëshmitari I konfirmoi se qëndronte plotësisht pranë dëshmisë që i kishte dhënë Gjyqtarës Hetuese dhe Trupit Gjykues të Shqyrtimit Gjyqësor të parë në vitin 2003.<sup>121</sup>

38. Dëshmitari I dha dëshmi lidhur me ngjarjet që i ndodhën xxxxx, A.M. (T.). Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor,



39. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitarit I dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. Më ose rreth datave 23/02/1999, Dëshmitari I ishte në shtëpi rreth mesnatës, kur ai u kuptoi se përreth shtëpisë së tij ndodheshin disa persona të paidentifikuar. Për këtë arsye, Dëshmitari I u nis të kalonte 30 metra nga shtëpia e tij për në shtëpinë e **xxxxx** A.M.. Rrugës ai hasi në ushtarë të armatosur të UÇK-së në uniforma të zeza. Dëshmitari I njohu njërin prej tyre si H.B. nga fshati **xxxxx**. Ai njohu dy të tjerë si shokë të shkollës. Njëri prej tyre, J.E., i tha atij 'Më vjen keq për ty, por kam urdhër nga lart. Duhet ta dërgojmë vëllain tënd në Shtab'. Dëshmitari I u përgjigj se vëllai i tij kishte qenë atje më parë për 60 ditë dhe kishte vuajtur shumë. J.E. dhe J.Z. nga fshati **xxxxx** deklaruan se 'nuk kemi opsion tjetër përveç se t'u bindemi urdhrave që na janë dhënë.' Pas një diskutimi me radio, që konfirmoi urdhrin për ta sjellë A.M. në Shtab atë natë, ushtarët e UÇK-së deklaruan se do ta dërgonin A.M. në Llapashticë.<sup>125</sup> Arrestimi më 23 shkurt ishte paraburgimi i dytë i A.M. nga UÇK dhe kjo ishte hera e fundit që Dëshmitari I e pa A.M. të gjallë.<sup>126</sup>
- b. Dëshmitari I deklaroi se më parë A.M. ishte paraburgosur në Llapashticë rreth datave 28-29 nëntor 1998 për rreth 60 ditë. Në atë rast, Dëshmitari I e kishte dërguar vëllain e tij atje me veturë dhe me të mbërritur, **L.G.** u kishte thënë atyre, 'Dërgojeni poshtë, sepse shpejt do t'ju bashkohem juve.' Ata shkuan në një ndërtesë tjetër rreth 500 metra më tutje. Shtëpia e policisë ushtarake ishte rreth 100 metra nga Shtabi i UÇK-së.<sup>127</sup>
- c. Pas rreth 10 minutash, **L.G.** erdhi atje bashkë me dy ushtarë të tjerë të UÇK-së. Ata ishin të gjithë të armatosur. Dëshmitari I arriti ta njohë **L.G.**, sepse e njohte **L.G.** që në **xxxxx**.<sup>128</sup>
- d. Dëshmitari I llogariti se atje ishin deri në 24 të burgosur, të cilët mbaheshin në një plevicë/stallë në Llapashticë.<sup>126</sup>
- e. Gjatë gjithë periudhës së paraburgimit të parë të A.M. në Llapashticë, Dëshmitari I shkoi rregullisht për të folur me komandantët e UÇK-

---

<sup>125</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 20/02/2002, f. 2; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/06/2003, f. 3-4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 4-5

<sup>126</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 6, f. 8 (megjithëse e thënë shprehimisht në këto referenca, ishte gjithashtu qartazi e nënkuptueshme në raste të tjera se Dëshmitari I dha dëshmi)

<sup>127</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 20/02/2002, f. 3-4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/06/2003, f. 4

<sup>128</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 20/02/2002, f. 4

së. Ai foli personalisht me **N.M.** (i cili thirrej 'xxxxx'). **L.G.** ('xxxxx') nuk pranoi ta takonte Dëshmitarin I. Në një rast, Dëshmitari I u lejua të hynte në ndërtesën e policisë ushtarake dhe ai foli përsëri personalisht me **N.M.**, i cili kishte veshur uniformë të zezë. **N.M.** u përshkrua se ishte 'zëvendës i xxxxx' nga një ushtar tjetër i njohur për Dëshmitarin I si G.Z. ('xxxxx'). **N.M.** i tregoi Dëshmitarit I se ishte e pamundur që ai të vizitonte A.M., sepse A.M. ishte nën hetim. Në një vizitë tjetër, Dëshmitarit I iu tregua nga një ushtar i UÇK-së në uniformë të zezë, i njohur si S.G., se Dëshmitari I nuk mund ta shihte A.M., sepse 'ai është ende në fazën e hetimit'. Për Dëshmitarin I, nga diskutimet e ndryshme të tij me **L.G.**, **N.M.** dhe të tjerë, gjithashtu u bë e qartë se arsyeja e paraburgimit të A.M. ishte se ai dyshohej se bashkëpunonte me serbët.<sup>127</sup>

- f. Në fund, ishte Komandant xxxxxx ai i cili urdhëroi lirimimin e A.M. (duke vërtetuar në këtë mënyrë se Komandant xxxxxx kishte dijeni si për faktin e paraburgimeve, ashtu dhe autoritet komandimi për të urdhëruar lirime).<sup>128</sup>
- g. A.M. i tregoi Dëshmitarit I për paraburgimin në Llapashticë. Atë e kishin mbajtur në një haur lopësh me rreth 23-24 njerëz të tjerë. Dëshmitari I iu referua një liste me 14 emra. A.M. e kishin torturuar dhe të gjithë i kishin keqtrajtuar emocionalisht dhe fizikisht. A.M. kishte vraga dhe mahisje në ballë dhe në shpinë. A.M. tha se atë e kishte rrahur **L.G.**. A.M. deklaroi se ishte akuzuar se organizonte prostitucion me policët serbë dhe xxxxxx (**L.G.**) i kishte thënë se 'për ta liruar veten nga ky mëkat', ai duhej të vriste një polic serb, për të provuar se ishte patriot.<sup>129</sup>
- h. Pas luftës, Dëshmitari I e gjeti trupin e A.M. të varrosur në një varr të cekët me të tjerë afër Majacit. Rrethanat e sakta të vdekjes ndërkohë që ishte në paraburgim të UÇK-së, janë jashtë sferës të këtij shqyrtimi gjyqësor, siç është përcaktuar nga Gjykata Supreme.

<sup>126</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 20/02/2002, f. 4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 5-6

<sup>127</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 20/02/2002, f. 5-6; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/06/2003, f. 4-5; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 8

<sup>128</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 20/02/2002, f. 7

<sup>129</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 20/02/2002, f. 7; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/06/2003, f. 5; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 20/06/2003, f. 5; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 11/04/2013, f. 7-8

40. Si përmbledhje, Dëshmitari I dha përshkrim të qartë, konciz, koherent dhe bindës se vëllai i tij u paraburgos dy herë nga UÇK në Qendrën e

Paraburgimit të Llapashticës, se kjo ishte bërë me urdhër të **L.G.** dhe se **L.G.** dhe **N.M.** kishin dijeni dhe ishin pjesëmarrës në rastet e vazhdueshme të rrahjeve, me arsyetimin se A.M. dyshohej se ishte bashkëpunëtor serb. Dëshmia e Dëshmitari I u mbështet dhe vërtetua në tërësi nga dëshmia e Dëshmitares J (shih paragrafin 41 më poshtë). Trupi Gjykses e pranon si të vërtetë dëshminë e Dëshmitarit I siç përcaktohet në paragrafin 39 (a) deri në (h) më lart.

**41. Dëshmia e Dëshmitares J (Shënim: Dëshmitarja J është dëshmitare e mbrojtur dhe JO Dëshmitare Anonime. Dëshmitarja J nuk ishte në gjendje të paraqitej në gjykatë [jeton në SHBA dhe për momentin ishte e paqasshme] dhe deklarata e saj u lexua dhe u përfshi në proces-verbal, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve më datë 07/05/2013, bashkëngjitur këtij Aktgjykimi në Shtojcën C).**

a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 19/02/2002

42. Dëshmitarja J ishte **xxxxx** e të ndjerit A.M. dhe Dëshmitarit I (më lart). Në thelb, dëshmia e Dëshmitares J mbështet atë të Dëshmitarit I dhe nuk është nevoja të paraqitet gjerësisht.

43. Si përmbledhje, Dëshmitarja J deklaroi si më poshtë:

a. Më 23/02/1999, A.M. (T.) u mor nga shtëpia e tij nga rreth 8 ushtarë të UÇK-së. Disa kishin veshur uniforma ushtarake, disa uniforma të zeza dhe të gjithë ishin të armatosur. Ky ishte një arrestim me forcë dhe A.M. nuk u vetë-dorëzua vullnetarisht.<sup>129</sup>

b. Dëshmitarja J bëri kërkime se me kë duhej të fliste në UÇK për të zbuluar fatin e vëllait të saj. Asaj i dhanë emrin e **L.G.**<sup>130</sup> Dëshmitarja J ishte në dijeni se A.M. kishte qenë arrestuar më parë me urdhër të **L.G.** në nëntor 1998 dhe kishte qenë paraburgosur në Llapashticë.<sup>131</sup> Gjatë atij paraburgimi, A.M. i tha Dëshmitares J se ai dhe të gjithë të paraburgosurit e tjerë ishin keqtrajtuar nga **L.G.** dhe A.M. i tregoi familjes lëndimet e tij. <sup>132</sup> A.M. i tregoi Dëshmitares J se të paraburgosurit e tjerë përfshinin I.S., A.K., H.J. dhe të tjerë.<sup>133</sup>

---

<sup>129</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 2

<sup>130</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 3

<sup>131</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 5

<sup>132</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 7

<sup>133</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 7



Dëshmitarja J deklaroi se A.M. ishte liruar nga paraburgimi i parë me urdhrin për të vrarë një polic serb, që familja e tij nuk e lejoi ta bënte.<sup>134</sup> Pas një farë kohe, ajo arriti të fliste me **L.G.** i cili e pyeti atë për marrëdhëniet e pretenduara ndërmjet A.M. dhe një shoku i cili ishte polic serb.<sup>135</sup> Dëshmitarja J kishte dijeni se L.G. njihej edhe si 'xxxxx' dhe "xxxxx".<sup>136</sup> Pasi filloi paraburgimi i datës 02/1999, **L.G.** nuk pranoi të fliste me Dëshmitaren J. Ushtarë të tjerë të UÇK-së i treguan asaj se A.M. po mbahej i paraburgosur në një stallë me të burgosur të tjerë. Dëshmitarja J dhe vëllai i saj, Dëshmitari I, arritën të flasim me një polic të nivelit të lartë, i cili u prezantua si **N.M.**, por ai thjesht vuri policë të tjerë që t'i përzinin nga oborri i burgut.<sup>137</sup>

- c. Familja nuk e pa A.M. gjallë përsëri. Ai u gjet pas një farë kohe në të njëjtin varr me D.B.. Rrethanat e sakta të asaj vdekjeje janë jashtë sferës së këtij Shqyrtimi Gjyqësor si rrjedhojë e aktvendimit të Gjykatës Supreme.

44. Ky Trup Gjykues e gjen dëshminë e Dëshmitares J të qartë, koncize dhe bindëse dhe të vërtetuar nga dëshmia e Dëshmitarit I. Faktet e paraqitura në paragrafin 43 (a) deri në (c) janë të provuara.

**45. Dëshmia e Dëshmitares C (Shënim: Dëshmitarja C nuk është dëshmitare e mbrojtur dhe JO dëshmitare anonime, sepse identiteti dhe shënimet personale të saj u morën në gjykatë në prani të palëve dhe mbrojtësve të tyre. Pas kësaj ajo dha dëshmi në seancë të hapur publike, por vazhdoi të përdorte pseudonimin e Dëshmitares C)<sup>138</sup>**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 7/02/02
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 29/04/03
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 11/04/2013

---

<sup>134</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 5-6

<sup>135</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 4

<sup>136</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 8

<sup>137</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 19/02/2002, f. 8

<sup>138</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 10

46. Në shqyrtimin gjyqësor të datës 11 prill 2013, Dëshmitarja C konfirmoi se qëndronte plotësisht pranë dëshmisë **xxxxx** para Gjyqtares Hetuese dhe para Trupit Gjykues të Shqyrtimit Gjyqësor të parë në vitin 2003.<sup>139</sup>

47. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitares C dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, dëshmia e saj mund të përmblihet si më poshtë:

- a. Dëshmia e Dëshmitares C ishte në lidhje me **xxxxx**, H.
- b. Rreth datës 30/01/1999, H. mori një thirrje nga UÇK. Më 31/01/1999, ai u paraqit në Shtab. Ai përfundoi në Llapashticë. Pas 4 ditësh, ai nuk ishte kthyer në shtëpi, prandaj Dëshmitarja C shkoi në Llapashticë për të marrë vesh se çfarë kishte ndodhur. **xxxxx** kërkoi të takonte Komandant **xxxxx**. Pas 10 minutave atë e dërguan në një shtëpi dykatëshe në të cilën ishte një dhomë si zyrë me dy persona të cilët ajo mendoi se ishin policë. Ajo iu prezantua atyre. Njëri ishte **L.G.**, i cili kishte veshur uniformë ushtarake. Ajo ishte në gjendje të përshkruante me saktësi pamjen fizike të **L.G.**. Tjetri ishte **N.M.**, i cili ishte veshur në uniformë të zezë. Ajo ishte në gjendje të përshkruante me saktësi pamjen fizike të **N.M.**.<sup>140</sup> Më pas, Dëshmitarja C e identifikoi **L.G.** para Gjyqtares Hetuese nëpërmjet fotografive të identifikimit.<sup>141</sup>
- c. Dëshmitarja C u tha atyre se ajo dëshironte to shihte **xxxxx**. Të dy burrat i thanë asaj se ai do të akuzohej. Ata e pyetën nëse ajo e dinte se ai ishte martuar me një serbe, që ajo deklaroi se ishte qesharake. Bashkëshortin e saj e sollën në dhomë dhe akuzat kundër tij ia bënë në prani të saj. Ajo e përshkroi kështu gjendjen e tij: 'ai ishte shumë gri në fytyrë, dhe ai përpiqej ta mbante veten drejt, megjithëse mezi lëvizte. Ai u përpoq të hynte në dhomë shumë ngadalë, me trupin si të mpirë dhe u ul shumë ngadalë dhe përpiqej të mos më linte ta shihja se nuk ndjehej mirë.' Dukej se kishte dhimbje. Ai nuk kishte pasur shenja të tilla dhimbjeje / lëndimi para paraburgimit të tij në Llapashticë. Dëshmitarja C gjithashtu i demonstroi fizikisht lëvizjet e H. në mënyrë të tillë që është e qartë se ajo po tregonte dhimbje

---

<sup>139</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 11

<sup>140</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 07/02/2002, f. 1-4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 29/04/2003, f. 8

<sup>141</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 07/02/2002, f. 15

-verbal i

shqyrtimit gjyqësor,

dhe shqetësim.<sup>142143</sup> Megjithëse Dëshmitarja C fillimisht nuk i specifikoi akuzat, ajo vrojtoi se akuzat u bënë nga S.H., kundër të cilit rreth 3 ose 4 vjet

më parë kishte pasur një konflikt brenda **xxxxx**. Si rrjedhim, dëshmitarja deklaroi se akuzat që shpunë në arrestim ishin një grindje e vogël ndërmjet familjeve, që rezultoi në akuza të rreme. Më vonë, në intervistën e saj, Dëshmitarja C konfirmoi se edhe H. po akuzohej se kishte punuar me policinë serbe, megjithëse ajo mohoi që kjo të ishte e vërtetë, duke deklaruar se ai vetëm sa kishte punuar në **xxxxxxxx**.<sup>144</sup> Kur erdhi në dhomë, ai shoqërohej nga policë të armatosur. Kur u largua nga dhoma, H. deklaroi se atë nuk do ta detyronin të pranonte diçka që ai nuk e kishte bërë dhe ata nuk mund të më etiketojnë bashkëpunëtor.<sup>145</sup> Dëshmitarja C nuk u lejua të flasë me **xxxxxx**. Kur Dëshmitarja C e kundërshtoi **L.G.** dhe **N.M.**, ata iu përgjigjën me kërcënime duke deklaruar se ata kishin të drejtë ta 'shfarosin' atë. Pastaj të dy këta persona kërkuan që ajo të dorëzonte një armë që mbahej nga familja e saj dhe se në rast se ajo nuk e bënte këtë, 'djali yt i cili është në mërgim, do të ishte në rrezik në qoftë se ti e mbështet bashkëshortin tënd, ose nuk bindesh'.<sup>146</sup>

- d. Dëshmitarja C shkoi në të njëjtin vend 2 ose 3 ditë më vonë dhe dorëzoi armën, megjithëse nuk e lejua të shihte bashkëshortin e saj. Përsëri ajo u përball me **L.G.** dhe **N.M.**. Megjithatë asaj i thanë se hetimet lidhur me bashkëshortin e saj po vazhdonin.<sup>147</sup>
- e. Më vonë Dëshmitarja C mori një mesazh nga një person i pidentifikuar, ku thuhej se bashkëshorti i saj ishte në gjendje të rëndë. Kjo e bëri atë t'i dërgonte një Deklaratë A.D., Përfaqësues Politik i UÇK-së në Prishtinë.<sup>148149</sup> Në fund, H. vdiq në rrethana që duket se lidhen me paraburgimin e tij nga UÇK, por kjo është jashtë sferës së këtij shqyrtimi gjyqësor, siç është përcaktuar nga Gjykata Supreme.

---

<sup>142</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 07/02/2002, f. 12-13; Proces  
<sup>143</sup> /04/2013, f. 12

<sup>144</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 07/02/2002, f. 12

<sup>145</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 07/02/2002, f. 12; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 29/04/2003, f. 10, f. 15-16

<sup>146</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 07/02/2002, f. 5-6; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 12-13

<sup>147</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 07/02/2002, f. 7; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 29/04/2003, f. 12

<sup>148</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 07/02/2002, f. 8; Proces  
<sup>149</sup> /04/2003, f. 10-11

-verbal i

shqyrtimit gjyqësor,

48. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se Dëshmitarja C dha dëshmi në mënyrë të qetë, të përmbajtur dhe të matur. Kur diçka ishte jashtë dijenisë së saj, ose kur ishte e pasigurt në kujtesën e saj, ajo shprehte rezerva të rregullta lidhur me atë fakt. Dëshmia e saj nuk shfaq shenja ekzagjerimi, domethënë, ajo është në gjendje të përshkruajë se bashkëshorti i saj u paraburgos kundër vullnetit të tij, se brenda 4 ditëve të paraburgimit të tij ai shfaq shenja lëndimi, që nuk i kishte pasur kur u paraqit vetë në UÇK, dhe si **L.G.**, ashtu dhe **N.M.** vepronin bashkë me qëllimin e qartë për të hetuar, marrë në pyetje dhe vazhduar paraburgimin e H.. Trupi Gjykses e gjen dëshminë e saj të besueshme, bindëse dhe koherente, pa ekzagjerime. Për rrjedhojë, faktet e dhëna në Paragrafin 47 (a) deri në (e) më lart janë të provuara.

**49. Dëshmia e Dëshmitari P (Shënim: Dëshmitari P është dëshmitar i mbrojtur dhe JO dëshmitar anonim, sepse identiteti dhe shënimet personale të tij u morën në gjykatë në prani të palëve dhe mbrojtësve të tyre. Pas kësaj ai dha dëshmi në seancë të hapur publike, por vazhdoi të përdorte pseudonimin Dëshmitari P)**

- a. Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese më 07/03/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 06/05/2003
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 11/04/2013

50. Në shqyrtimin gjyqësor të datës 11 prill 2013, Dëshmitari P konfirmoi se i qëndronte plotësisht pranë dëshmisë së dhënë para Gjyqtarës Hetuese dhe para Trupit Gjykses të Shqyrtimit Gjyqësor të parë në vitin 2003.

51. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitarit P dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. Dëshmitari P është **xxxxx** i I.S.. I.S. u arrestua nga UÇK më 2/11/1998. Më 3/11/1998, Dëshmitari P mori vesh se vëllai i tij nuk ishte marrë nga serbët, siç kishte pasur frikë në fillim, por nga Policia Ushtarake e UÇK-së për biseda informative.<sup>149</sup> Hulumtimet e mëtutjeshme zbuluan se I.S. po mbahej në Llapashticë.<sup>150</sup>
- b. Si rezultat i atij informacioni, Dëshmitari P bashkë me babanë e tij u paraqitën në Llapashticë dhe folën me **L.G.** në Shtabin e Zonës. Në  
-verbal i

shqyrtimit gjyqësor,

atë kohë **L.G.** përdorte pseudonimin 'xxxxx', që është një pseudonim tjetër që i është vënë **L.G.** nga dëshmitarë të ndryshëm. Kur e pyetën **L.G.** përse ishte arrestuar I.S., **L.G.** u përgjigj 'në

<sup>149</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 07/03/2002, f. 2-3; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 06/05/2003, f. 2-3; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 22

<sup>150</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 07/03/2002, f. 3; Proces 06/05/2003, f. 3

mënyrë shumë të vrazhdë. Ai nuk donte të na tregonte përse ishte arrestuar **xxxxx** dhe më tha zhduku që këtu.' **L.G.** nuk i konfirmoi se I.S. ishte paraburgosur në Llapashticë. Megjithatë, një ushtar aty pari e informoi Dëshmitarin P ku ishte paraburgosur **xxxxx**.<sup>150</sup>

- c. Të nesërmen, Dëshmitari P dhe të afërm të tjerë u kthyen përsëri në Llapashticë me ushqime dhe tesha për I.S.. Ata nuk u lejuan ta vizitojnë atë. Me gjithë vizitat e rregullta të shpeshta të mëtutjeshme, Dëshmitari P nuk arriti ta vizitonte I.S. Rreth datës 23 nëntor, në një vizitë të tillë, **L.G.** përsëri e pa Dëshmitarin P dhe përsëri i bëri kërcënime për vdekje.<sup>151</sup>
- d. Në një fazë, I.S. arriti të nxirrte fshehurazi një letër jashtë Qendrës së Paraburgimit për familjen e tij. Dëshmitari P deklaroi se në letër ishte shkruar '**L.G.** po e keqtrajton dhe dhunon atë (domethënë, I.S),' po e rreh dhe torturon dhe ai i lutej Dëshmitarit P të shkonte tek A.D. për ndihmë, për të siguruar lirin e I.S.<sup>152</sup>
- e. Pas luftës, kur po përpiquej të gjente vëllain e tij, Dëshmitari P foli me një komandant të UÇK-së të quajtur 'L.' (I.S.). Ai i tha Dëshmitarit P të fliste me **L.G.**, sepse vëllai i P-së kishte qenë në duart e **L.G.**.<sup>153</sup> I.S. u gjet në një varr në Majac. Megjithëse ndoshta ai vdiq ndërsa ishte në duart e UÇK-së, kjo është jashtë sferës së këtij shqyrtimi gjyqësor, siç është përcaktuar nga Gjykata Supreme.

52. Kur Dëshmitari P dha dëshminë e tij, ai ishte ende qartazi shumë emocional dhe i prirë për të debatuar me Mbrojtësit dhe të pandehurit. Megjithatë, një analizë e kujdesshme e dëshmisë së tij tregon se, me gjithë emocionet e tij, ajo që ai në fakt tha ishte e matur, e kufizuar dhe pa prirje për ekzagjerim. Trupi Gjyqësor e gjen dëshminë e tij bindëse dhe të vërtetë dhe faktet në Paragrafin 51 (a) deri në (e) më lart janë të provuara.

---

<sup>150</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 07/03/2002, f. 3; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 06/05/2003, f. 4, f. 9; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 24

<sup>151</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 07/03/2002, f. 3-4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 23; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 11/04/2013, f. 25

<sup>152</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 07/03/2002, f. 4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 06/05/2003, f. 4, f. 6

<sup>153</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 07/03/2002, f. 5

**53. Dëshmia e A.A. (fillimisht Dëshmitar Anonim, i njohur si Dëshmitari 4, A.A. zgjodhi të hiqte dorë nga anonimiteti i tij në shqyrtimin gjyqësor – shih proces-verbalin e datës 08/05/2013, f. 7)**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 14/05/2002 (e shpallur me aktvendim si e papranueshme dhe prandaj nuk është marrë parasysh nga Trupi Gjykses – shih paragrafin 8 më lart).
- b. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 18/10/2002
- c. Proces-verbalet e Shqyrtimit Gjyqësor më 20/03/2003, 21/03/2003
- d. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 18/09/2009
- e. Proces-verbalet e Shqyrtimit Gjyqësor më 08/05/2013, 10/05/2013

**54. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitarit A.A. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:**

- a. A.A. deklaroi se nuk qëndronte pranë përgjigjeve të dhëna para Gjyqtares Hetuese më 18/10/2002, por qëndronte pranë përgjigjeve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor në vitin 2003. Meqenëse kjo është çështje ku duhet të përcaktohet besueshmëria nga ky Grup Gjykses, shqyrtohen të dy versionet e dhëna nga i pandehuri.
- b. A.A. deklaroi se u rrëmbye nga UÇK në nëntor 1998, u dërgua Shtab në Bradash dhe u mor në pyetje për lidhjet e tij me serbët dhe u rrah (të pandehurit në këtë lëndë nuk akuzohen se kanë qenë palë në atë rrahje). Më vonë “xxxxx’ [L.G.], të cilin A.A. e njihte më parë, shkoi me një xhip me dy ushtarë dhe e dërgoi A.A. me sy të lidhur për në Llapashticë. Në Llapashticë, A.A. ia dorëzuan Policisë Ushtarake dhe e burgosën.<sup>154</sup>
- c. A.A. deklaroi se menjëherë ishte rrahur nga policia ushtarake me shqelma, duar dhe pushkë për rreth 20 minuta. Ai nuk mendon se L.G. mori pjesë personalisht.<sup>155</sup>
- d. Pastaj atë e vendosën në një dhomë paraburgimi. Të burgosurit e tjerë të pranishëm përfshinin: N.H., H. nga xxxxxx, B. nga xxxxxx, I.S., A.M., M. nga xxxxxx, M. nga xxxxxx dhe M. nga xxxxxx. Qelia ishte një

---

<sup>154</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 18/10/2002, f. 3

<sup>155</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 18/10/2002, f. 3-4

plevicë me dysHEME çimentoje me vetëm 2 ose 3 dyshekë për të gjithë. Asnjëri nuk mund të flinte mirë për shkak të lëndimeve të marra nga rrahjet, disa prej të cilave A.A. i dëshmoi vetë.<sup>156</sup>

- e. Pas disa ditësh, A.A. u rrah përsëri nga policia ushtarake me shkopinj dhe elektricitet ndërkohë që merrej në pyetje për bashkëpunim me serbët.<sup>157</sup> A.A. dëshmoi se si u morën të tjerë për t'u marrë në pyetje dhe pa dhe diskutoi për lëndimet e tyre nga rrahjet.<sup>158</sup>
- f. Në Qendrën e Paraburgimit u bë një vizitë nga Kryqi i Kuq. Para asaj vizite, A.A. deklaroi se policia ushtarake u tha të paraburgosurve se ata po trajtoheshin mirë nga policia ushtarake. Në përgjigje të këtij udhëzimi, A.A. deklaroi se të burgosurit bënë siç i kishin udhëzuar.<sup>159</sup>
- g. Emri i vërtetë i 'xxxxx' ishte **L.G.**. Përveç rastit të përshkruar më lart, A.A. mohon ta ketë parë **L.G.** në Llapashticë. Ai mohon ta ketë parë **N.M.** në Llapashticë. A.A. mohon të ketë ditur ndonjëherë se cili person ishte përgjegjës për të burgosurit.<sup>160</sup>
- h. A.A. u lirua rreth datës 23 mars. Në atë kohë, të burgosurit përfshinin V.J., A. K., H., D. dhe të tjerë. Pothuajse në të njëjtën kohë, A.A. dëgjoi nga të tjerë se A.T., I.S. dhe D. i kishin detyruar të hapnin gropa dhe i kishin vrrarë.<sup>161</sup><sup>162</sup>
- i. Në shqyrtimin gjyqësor të datës 20/03/2003, A.A. paraqiti një histori krejt të kundërt. Ai deklaroi se u paraqit në Llapashticë vullnetarisht, sepse për të qarkullonin histori të rreme dhe ai donte të siguronte mbrojtje nga UÇK në Llapashticë. Në këtë version të ri të ngjarjeve, A.A. ishte në të gjitha herët i lirë të vinte dhe të shkonte siç dëshironte. Ai qëndroi në Llapashticë vullnetarisht. Kushtet u përshkruan si njëloj të mira si ato të ushtarëve dhe ai punonte lirisht për detyrat e nevojshme ushtarake. Ai konfirmoi praninë e të paraburgosurve të tjerë, përfshirë 'A.' dhe 'H.'. Ai mohoi kategorikisht të ishte arrestuar ose ndaluar kundër vullnetit të tij. Kur u ballafaqua nga Kryetari i Trupit Gjyqësor në vitin 2002 për dëshminë e tij para Gjyqtarës Hetuese, A.A. deklaroi 'se çdo gjë që thashë para policisë dhe Gjyqtarës Hetuese ndodhi pasi policia më

---

<sup>156</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 18/10/2002, f. 4-5

<sup>157</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 18/10/2002, f. 5-7

<sup>158</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 18/10/2002, f. 9-10

<sup>159</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 18/10/2002, f. 19

<sup>160</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 18/10/2002, f. 11

<sup>161</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 18/10/2002, f. 12-13

<sup>162</sup> /03/2003, f. 5-6



kishte kërkuar që të bashkëpunoj dhe unë mund të fitoja 100,000 euro dhe mund të shkoja të jetoja në çdo vend.<sup>163</sup> Madje ai e akuzoi Gjyqtaren

Hetuese se i kishte treguar si ta jepte dëshminë e tij dhe të thoshte se ai e kishte njohur **xxxxx** që para se **xxxxx** të kyçej në ushtri. Ai mohoi ta kishte parë **xxxxx** më parë, deri kur ai ishte arrestuar nga KFOR-i. Kur atij iu vu në dukje se nëse i kishin treguar të implikonte **xxxxx**, në fakt ai i kishte treguar Gjyqtares Hetuese se nuk e dinte nëse **xxxxx** kishte qenë prezent në rrahjet, A.A. nuk dha ndonjë përgjigje të logjikshme në atë pikë, duke deklaruar thjesht se ai nuk mund ta akuzonte **xxxxx** nëse nuk ishte e vërtetë, ndërsa në fakt ai po akuzonte Gjyqtaren dhe policinë, sepse e udhëzuan t'i ekzagjeronte akuzat kundër **xxxxx**.

- j. A.A. gjithashtu deklaroi se kur u intervistua nga Gjyqtarja Hetuese më 18 tetor, asnjë Mbrojtës nuk kishte qenë prezent. Ky pohim ishte qartazi i gabuar, siç u vërtetua nga dy fakte: i/ proces-verbali i datës 18 tetor 2002 tregon se 3 Mbrojtës ishin prezent dhe ii/ të njëjtët Mbrojtës ishin prezent edhe në shqyrtimin gjyqësor përpara këtij Trupi Gjykues në vitin 2013 dhe nuk deklaruan se proces-verbali i vitit 2002 ishte i gabuar. Prandaj është dëshmia e A.A. ajo që duhet të jetë e gabuar, sepse ai po gënjen, ose sepse po gabon. Më tej A.A. pohon se Gjyqtarja Hetuese i paraqiti një Deklaratë të parashkruar, që ishte e rreme. Trupi Gjykues e hedh poshtë këtë pohim si gënjeshtër. A.A. pohon se A.K. gjithashtu i tregoi atij se kishte ardhur në Llapashticë në mbrojtje të vetes.<sup>164</sup> Ky pohim shpërfill dëshmitë e tjera lidhur me paraburgimin me forcë dhe rrahjet e A..
- k. Në shqyrtimin gjyqësor në vitin 2013, A.A. dha një përshtkrim në thelb të ngjashëm me atë të dhënë para Trupit Gjykues në vitin 2003, se ai ishte dorëzuar vullnetarisht në UÇK për mbrojtje, se ai ishte trajtuar mirë dhe se nuk kishte pasur rrahje dhe se ai ishte i lirë të largohej kurdo të dëshironte. Ai u ballafaqua gjerësisht nga Prokurori për përshtkrimin e tij të mëparshëm në tetor 2002, në të cilin ai kishte deklaruar se ishte paraburgosur jo vullnetarisht nga UÇK, se ishte mbajtur i burgosur dhe se në mënyrë të përsëritur ishte marrë në pyetje dhe ishte rrahur, dhe se kishte parë të rriheshin të paraburgosur të tjerë dhe kishte dëshmuar lëndimet e tyre. Këtu nuk është e nevojshme të shënojmë çdo ballafaqim një për një. A.A. ishte tejet dredhues në përgjigjet e tij dhe herë pas here dukej krejtësisht i pazoti për t'i dhënë përgjigje qoftë një pyetjeje të thjeshtë. Në thelb, kur u ballafaqua me ndonjë ndryshim ndërmjet përshtkrimeve, ai pohoi se përshtkrimi i parë ishte i pasaktë. Në mënyra të ndryshme, arsyet e dhëna ishin këto:

- i. 'Policia e UNMIK-ut më bindi të jap deklaratë dhe tha se unë do të isha dëshmitar i mbrojtur dhe ata do të më dërgonin jashtë shtetit. Deklaratat që dhashë nuk m'u treguan asnjëherë, që unë t'i këqyrja dhe të shihja çfarë ishte shënuar në proces-verbal.'<sup>163</sup>
- ii. 'Çfarëdo që të ketë përkthyer përkthyesi atje, është krejt e ndryshme.' [d.m.th. gabime në përkthim]<sup>164</sup>
- iii. Se atij i ofruan "100,000 euro dhe të shkoja në një vend tjetër."<sup>165</sup>
- iv. Megjithëse në vitin 2003 kishte deklaruar se atë e kishte detyruar policia e UNMIK-ut dhe/ose Gjyqtarja Hetuese të jepte dëshmi të rreme, para Trupit Gjykues në vitin 2013, ai mohoi të kishte qenë nën trysni për të dhënë përgjigje.<sup>166</sup> Kjo bie ndesh me ato që A.A. deklaroi në marrjen në pyetje nga palët në vitin 2013, kur deklaroi 'Kur shkova në gjykatë, më treguan për disa deklarata dhe, duke ditur se nuk kisha asgjë ose nuk kisha shumë për të thënë, më dhanë një deklaratë që duhej ta lexoja ose thosha' dhe 'unë ia thashë Gjyqtares Hetuese ato gjëra, sepse ajo më tha është më mirë për ty që të flasësh në këtë mënyrë, prandaj e dhashë deklaratën pa dëshirën time...' 'Ajo më tregoi të them se e njihja ~~xxxxx~~ dhe e njihja para se ai të kycej në UÇK dhe se unë e pashë atë në ushtri dhe se ai na keqtrajtoi mua dhe të tjerët.'<sup>167</sup><sup>168</sup> Kur u sfidua nga Kryetari i Trupit Gjykues në vitin 2013, konkretisht nëse po pretendonte se deklarata e tij para Gjyqtares Hetuese ishte qëllimisht e rreme, A.A. u përgjigj 'Deklarata ime ishte përgatitur tashmë, atë që përktheu përkthyesi, ata e dinin tashmë.'<sup>170</sup>

55. Në përfundim, si dëshmitar A.A. nuk i la asnjë përshtypje Trupit Gjykues. Ai ishte dredhues, i vështirë dhe, bazuar në shpjegimet më të shtira dhe qesharake, u përpoq ta bindte këtë Trup Gjykues se deklarimi i plotë, i ndërlikuar dhe i hollësishëm që i kishte dhënë fillimisht Gjyqtares Hetuese, nuk ishte aspak i saktë dhe ishte rezultat i sjelljes së pandershme dhe të

---

<sup>163</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 08/05/2013, f. 13; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/05/2013, f. 3

<sup>164</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 08/05/2013, f. 22

<sup>165</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 08/05/2013, f. 23, f. 28; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/05/2013, f. 4

<sup>166</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 08/05/2013, f. 23

<sup>167</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/05/2013, f. 3-4

<sup>168</sup> /05/2013, f. 4

paligjshme të Gjyqtares Hetuese, policisë së UNMIK-ut dhe përkthyesve të UNMIK-ut, të cilët vepruan bashkërisht për të krijuar një rrëfim krejt të rremë të ngjarjeve në Llapashticë. Skenari alternativ i paraqitur nga A.A. është po aq jo bindës, konkretisht, se ai u dorëzua në UÇK në Llapashticë vullnetarisht, për të mbrojtur veten, dhe se ai nuk u arrestua dhe paraburgos asnjëherë, dhe se në të gjitha herët u trajtua mirë dhe nuk pa kurrë shenja të keqtrajtimit të vetes ose të paraburgosurve të tjerë. Trupi Gjykues arrin në përfundimin se përshkrimi i parë që dëshmitari i dha Gjyqtares Hetuese më 18 tetor 2002 ishte i vërtetë. Megjithatë, për shkak se në përgjithësi A.A. është një dëshmitar kaq i dobët, Trupi Gjykues nuk gjen as edhe një fakt të vetëm të provuar, bazuar vetëm në fjalët e A.A.. Për aq sa dëshmia e A.A. mbështetet dhe vërtetohet nga dëshmitarët e tjerë, ai fakt mund të konsiderohet i provuar. Për aq sa ndonjë fakt varet vetëm nga dëshmia e A.A., i pambështetur nga të tjerë, ai konsiderohet i paprovuar. Prandaj, nga dëshmia e A.A., konsiderohen të provuara faktet e mëposhtme:

- i. Se në Llapashticë kishte një kamp paraburgimi të UÇK-së;
- ii. Se A.A. u paraburgos atje,
- iii. Se bashkë me A.A. u paraburgosën dhe të tjerë, përfshirë të paktën A. dhe H., dhe se të paraburgosurit u rrahën dhe pësuan lëndime.

Meqenëse asnjë dëshmi ose provë e pavarur nuk mund të mbështesë apo të mohojë se A.A. u rrah në Llapashticë, ky fakt nuk mund të konsiderohet i provuar.

**56. Dëshmia e Dëshmitares D (Kjo dëshmitare NUK është dëshmitare anonime, por është dëshmitare e mbrojtur. Kjo dëshmitare tani jeton në xxxxx dhe nuk u arrit të gjendej. Dëshmia e mëparshme e saj u lexua dhe u shënua në proces-verbal, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve më 7 maj 2013 [Shtojca C bashkëngjitur këtij Aktgjykimi]).**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 12/02/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 07/04/2003
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 09/04/2003

57. Kjo dëshmitare ishte bashkëshortja e A.K.

Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor,

58. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitares D dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- 175 a. A.K. ishte një burrë i moshuar me shëndet të lig. Ai kishte qenë  
176 mësues për 30 vjet. Më 07/02/1999 ai u rrëmbye / arrestua nga  
177 UÇK. Ushtarët e UÇK-së hynë kur A.K. dhe Dëshmitarja D po flinin.  
178 Ushtarët ishin në uniforma ushtarake dhe të armatosur. A.K. dhe  
179 dëshmitaren D i zgjuan dhe i urdhëruan të vishen dhe ushtari që i  
180 arrestoi ishte i dhunshëm ndaj A.K.. Ushtarët gjithashtu kërkuan që  
181 armët në posedim të A.K. t'u dorëzoheshin atyre. Dëshmitari D u  
182 dorëzoi një revole dhe një pushkë gjuetie. Ushtarët i thanë A.K. që  
183 do ta merrnin e dërgonin në Llapashticë. Vajzat e A.K. ishin prezent  
184 në shtëpi gjatë arrestimit të tij dhe u vunë në gjendje ankthi.<sup>169</sup>
- 185 b. Të nesërmen, Dëshmitarja D dhe një i afërm mashkull u paraqitën  
186 në Shtabin e UÇK-së në Llapashticë për të pyetur për A.K.. Ndërkohë  
187 që ishin atje, Dëshmitarja D pa dhe njohu **L.G.**, të cilin ajo e njohte që  
188 para luftës.<sup>170</sup> Dëshmitarja D deklaroi se **L.G.** e thërriste veten  
189 'xxxxx' ose 'xxxxx'.<sup>171</sup> Ajo nuk arriti të merrte informacion në  
190 Llapashticë dhe prandaj shkoi në Bradash. Për arsye që nuk kanë  
191 rëndësi tani për tani, Dëshmitaren D e bënë të besonte se A.K. ishte  
192 paraburgosur atje. Kjo nuk ishte e vërtetë, dhe pas një farë kohe,  
193 rreth një muaj pas paraburgimit të A.K., në një takim me Komandant  
194 xxxxx [S.R.], asaj i treguan se A.K. ishte paraburgosur në Llapashticë  
195 dhe ishte në duart e **L.G.** dhe **N.M.**.<sup>172</sup> xxxxx gjithashtu i tregoi  
196 Dëshmitares D se A.K. po vuante në burg. Ai po merrej në pyetje për  
197 bashkëpunim dhe po e keqtrajtonin dhe rrihnin.<sup>173174175</sup>
- 198 c. Në një rast të mëvonshëm, xxxxx mundi të organizonte një takim të  
199 fshehtë ndërmjet Dëshmitares D dhe A.K. . A.K. ishte i sëmurë. A.K. i  
200 tregoi Dëshmitares D se e kishin paraburgosur në Llapashticë, se  
201 kushtet ishin shumë të këqija dhe se **L.G.** 'po e vret atë.' A.K. ishte i  
202 lodhur, i zbehtë, dhe kishte mahisje. Ai i kërkoi Dëshmitares D ta  
203 ndihmonin duke folur me familjen **L.G.**,  
204 Komandant xxxxx dhe Komandant xxxxx.<sup>176</sup>

---

<sup>169</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 12/02/2002, f. 4-7; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07/04/2002, f. 5-6

<sup>170</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 12/02/2002, f. 8-9

<sup>171</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 12/02/2002, f. 14

<sup>172</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 12/02/2002, f. 10

<sup>173</sup> Deklaratë para Gjyqtars Hetuese, 12/02/2002, f. 11; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 07/07/2002, f. 8-9

Gjyqtars Hetuese, 12/02/2002, f.12-13; Proces

<sup>174</sup> /07/2002, f. 8-9

<sup>175</sup> /02/2002, f. 14

Deklaratë para -verbal i shqyrtimit gjyqësor,

Deklaratë para Gjyqtars Hetuese,

205

d. Dëshmitarja D nuk e pa bashkëshortin e saj përsëri, megjithëse vajzat e tij e takuan një a dy herë të tjerë.<sup>177</sup> Më vonë ai u gjet në

206

një varr me H.J.. Rrethanat e sakta të vdekjes janë përtej shtrirjes së këtij shqyrtimi gjyqësor si pasojë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme.

59. Trupi Gjykues i kujton vetes se, kur vlerëson dëshminë e një dëshmitari që vetë Trupi Gjykues nuk e ka parë dhe as dëgjuar, i nevojitet kujdes shtesë. Në të vërtetë ai përdor këtë qasje me çdo dëshmitar të lexuar në këtë lëndë. Megjithatë, dëshmia e Dëshmitares D është e qartë, e përpiktë dhe bindëse në vetvete. Ajo vërtetohet nga dëshmitë e Dëshmitarëve E, F dhe G më poshtë dhe përputhet me ato të dëshmitarëve të tjerë në përgjithësi në këtë lëndë. Prandaj Trupi Gjykues e pranon si të vërtetë dhe faktet e paraqitura në paragrafin 58 (a) deri në (d) më lart janë të provuara.

**60. Dëshmia e Dëshmitares E (Kjo dëshmitare NUK është dëshmitare anonime, por është dëshmitare e mbrojtur. Kjo dëshmitare tani jeton në xxxxx dhe nuk u arrit të gjendej. Dëshmia e mëparshme e saj u lexua dhe u shënua në proces-verbal, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve më 7 maj 2013 [Shtojca C bashkëngjitur këtij Aktgjykimi]).**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 13/02/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 08/04/2003
- c. Kjo dëshmitare ishte xxxxxx e A.K.. Kjo dëshmitare në thelb vërteton përshkrimin e bërë nga Dëshmitarja D, prandaj mund të përmblihet shkurtimisht.

61. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitares E dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. Babai i saj, A.K., u mor nga UÇK në natën e datës 07/02/1999. Atje ndodheshin një numër ushtarësh të UÇK-së në uniforma dhe të armatosur. Ata u sollën në mënyrë agresive dhe të dhunshme, përfshirë goditjen e babait të saj.<sup>176</sup>
- b. Dëshmitarja E shkoi disa herë në Llapashticë për të marrë informacion për babanë e saj. Në fund ata u ndihmuan nga

---

<sup>176</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 12/02/2002, f. 2-4; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 08/04/2003, f. 2-4

Deklaratë para -verbal i shqyrtimit gjyqësor,  
Deklaratë para Gjyqtares Hetuese,



179 Komandant **xxxxx**, i cili i tregoi asaj se **L.G.** ishte personi që e  
180 mbante babanë e saj.<sup>179</sup> **xxxxx** rregulloi një takim të fshehtë  
181 ndërmjet A.K. dhe familjes së tij. Dëshmitarja E e përshkruan  
182 gjendjen e babait të saj si shumë të keqe, i ënjtur gjithandej, ai  
183 dridhej dhe duart i kishte të mbuluara me gjak. Ai qante, duke thënë  
184 se 'ata po më rrahin, po më vrasin, **L.G.** më rreh dhe i vë të tjerët të  
185 më rrahin.'<sup>180</sup>

186

187 62. Trupi Gjykses e vlerëson bindëse dëshminë e Dëshmitares E dhe faktet në  
188 paragrafin 61 (a)-(b) janë të provuara.

189

190

191

192 **63. Dëshmia e Dëshmitarit F (Ky dëshmitar NUK është dëshmitar anonim,**  
193 **por është dëshmitar i mbrojtur. Ky dëshmitar nuk u paraqit në**  
194 **gjykatë dhe nuk u arrit të gjendej. Dëshmia e mëparshme e tij u lexua**  
195 **dhe u shënua në proces-verbal, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve**  
196 **më 7 maj 2013 [Shtojca C bashkëngjitur këtij Aktgjykimi]).**

197

198

a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 13/02/2002

199

b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 29/04/2003

200

201

64. Ky dëshmitar ishte **xxxxx** i A.K. Ky dëshmitar në thelb vërteton  
202 përshkrimin e bërë nga Dëshmitarja D, prandaj mund të përmblihet  
203 shkurtimisht.

204

205

65. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitarit F dhe duke hequr ato  
206 pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo  
207 dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

208

209

a. Në një farë kohe pasi, A.K. ishte marrë nga UÇK. Dëshmitari F u  
210 paraqit në zonën e Potokut, bashkë me dëshmitarët E dhe G, në  
211 kërkim të A.K. . Ata arritën ta takojnë A.K. . Duart i kishte të zeza (të  
212 mahisura) dhe dukej sikur e kishin rrahur. Gjatë këtij takimi  
213 A.K. kishte deklaruar se Komandant **xxxxx** nuk do ta lironte.<sup>181</sup>

214

215

66. Megjithëse Trupi Gjykses vlerëson se dëshmitari ishte dëshmitar i  
216 ndershëm, që përpiqej të bënte ç'është e mundur për të dhënë dëshmi të

217

218

<sup>179</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 08/04/2002, f. 5

219

Gjyqtares Hetuese, 12/02/2002, f. 5-6; Proces

220

08/04/2003, f. 5-8

Deklaratë para -verbal i shqyrtimit gjyqësor,  
Deklaratë para Gjyqtares Hetuese,

222 saktë, kujtimi i ngjarjeve nga ana e tij është i turbullt. Ndonëse nuk ka  
223 mospërputhje me dëshmitë e Dëshmitarëve D, E dhe G deri në atë shkallë  
224 sa të minojë dëshmitë e tyre, Trupi Gjykses e merr parasysht dëshminë e  
225 Dëshmitarit F vetëm në masë të kufizuar, për aq sa ajo jep një vërtetim të  
226 përgjithshëm të dëshmimeve të tjera se çfarë i ndodhi A.K.

227  
228  
229

230 **67. Dëshmia e Dëshmitares G (Kjo dëshmitare NUK është dëshmitare**  
231 **anonime, por është dëshmitare e mbrojtur. Kjo dëshmitare nuk u**  
232 **paraqit në gjykatë dhe nuk u arrit të gjendej. Dëshmia e mëparshme**  
233 **e saj u lexua dhe u shënuar në proces-verbal, sipas marrëveshjes**  
234 **ndërmjet palëve më 7 maj 2013 [Shtojca C bashkëngjitur këtij**  
235 **Aktgjykimi]).**

236

- 237 a. Deklarata para Gjyqtarses Hetuese më 14/02/2002
- 238 b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqsor më 08/04/2003

239

240 **68.** Kjo dëshmitare ishte **xxxxx** e A.K.. Kjo dëshmitare në thelb vërteton  
241 përshkrimin e bërë nga Dëshmitarja D, prandaj mund të përmbliidhet  
242 shkurtimisht.

243

244 **69.** Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitares G dhe duke hequr ato  
245 pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo  
246 dëshmi mund të përmbliidhet si më poshtë:

247

- 248 a. Më 07/02/1999, disa ushtarë të UÇK-së shkuan në shtëpinë e A.K.  
249 dhe të kësaj dëshmitareje, për të arrestuar A.K. . Ata kishin veshur  
250 uniforma dhe ishin të armatosur.<sup>182</sup>
- 251 b. Dëshmitarja G shkoi në Llapashticë në kërkim të A.K. , por pa sukses.
- 252 c. Dikur dëshmitarja G u takua me Komandant **xxxxx**, i cili i tregoi asaj  
253 se **xxxxx** i saj mbahej pa asnjë arsye dhe konfirmoi se atë e kishin  
254 rrahur. **xxxxx** bëri një bisedë private me Dëshmitaren D (nëna e  
255 Dëshmitares G), si rezultat i së cilës ata mësuan se **L.** ishte personi  
256 që mbante A.K..<sup>183</sup>
- 257 d. Dëshmitarja G ishte prezent kur **xxxxx** rregulloi një takim sekret për  
258 A.K. dhe familjen e tij. A.K. u kishte konfirmuar se ishte sëmurë, se e  
259 kishin rrahur, se **L.G.** ishte personi kryesor që e mbante, i

260

261 Gjyqtarses Hetuese, 14/02/2002, f. 2; Proces

Deklaratë para -verbal i shqyrtimit gjyqsor,  
Deklaratë para Gjyqtarses Hetuese,

262

08/04/2003, f. 13-14

263

14/02/2002, f. 7-8

Deklaratë para -verbal i shqyrtimit gjyqësor,  
Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese,

mbështetur nga xxxxx. Në duart e tij kishte plagë. A.K. qante. A.K. kishte konfirmuar se e kishin marrë në pyetje dhe e kishin akuzuar kur ishte në paraburgim.<sup>184</sup>

70. Trupi Gjykses e vlerëson bindëse dëshminë e Dëshmitares G dhe faktet në paragrafin 69 (a)-(d) janë të provuara.

**71. Dëshmia e Dëshmitarit H (Ky dëshmitar NUK është dëshmitar anonim, por është dëshmitar i mbrojtur. Ky dëshmitar nuk u arrit të gjendej. Deklarata u lexua dhe u shënua në proces-verbal, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve më 7 maj 2013 [Shtojca C bashkëngjitur këtij Aktgjykimi])**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 06/02/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqsor më 05/05/2003

72. Ky dëshmitar ishte dëshmitar në arrestimin dhe paraburgim e D.B., e cila ishte nëna e dëshmitarit.

73. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitarit H dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmbliidhet si më poshtë:

- a. Në një datë në vitin 1998/1999, D.B. dhe djali i saj kishin qenë për vizitë tek një pjesëtar i familjes. Pak pasi ishin larguar nga shtëpia e atij të afërmi, një person u ishte afruar nga prapa me një armë në dorë dhe i urdhëroi të hipnin në një veturë. Ata hynë në veturë si pasojë e kërcënimit/urdhrit dhe i dërguan kundër vullnetit të tyre, me sy të lidhur dhe me kapuç mbi kokë. Pas një farë kohe, ata i dërguan në Llapashticë.<sup>185</sup> Rrëmbyesit kishin veshur uniforma të UÇK-së.<sup>186</sup>
- b. Në Llapashticë, Dëshmitari H dhe nëna e tij ishin nën kontrollin e ushtarëve në uniformë të zezë, të cilët Dëshmitari H besoi se ishin policë ushtarakë. Ata i vendosën 'në një qeli të errët, si qilar'.

<sup>184</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 14/02/2002, f. 8 & 13; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqsor, 08/04/2003, f. 15-17

185 Gjyqtares Hetuese, 05/02/2002, f. 2; Proces  
05/05/2002, f. 4

186 05/02/2002, f. 8

Dëshmitarin H e paraburgosën për tre dite dhe net dhe pastaj e liruan. Kur e liruan, nëna e tij nuk ishte liruar.<sup>177</sup>

- c. Gjatë paraburgimit të tij, Dëshmitari H dhe nëna e tij u morën në pyetje. Para marrjes në pyetje, Dëshmitari H dëgjoi emrin **L.G.** të përmendej nga ushtarët. Ai gjithashtu pa fytyrën e personit që i drejtoheshin me emrin **L.G.**. Kur D.B. u mor në pyetje, personi që e mori në pyetje i tha asaj 'Unë jam **L.G.**' Një ushtar tjetër iu drejtua **L.G.** me emrin '**xxxxx**'. **L.G.** kishte një nishan dallues në faqe. Kur D.B. u mor në pyetje, Dëshmitari H arriti të shihte nga dhoma e tij dhe të shikonte tejpertej një dritareje. Ai e pa **L.G.** duke i drejtuar një armë nënës së tij.<sup>178</sup> Ai pa një mashkull tjetër 'tullac me trup mesatar. Pas luftës, ai e njohu këtë person dhe ai ishte **N.M.**. Pasi e intervistuan nënën e tij, atë e kthyen në qeli dhe ajo qante. Nëna e tij i tregoi Dëshmitarit H se e kishin akuzuar për spiunazh për serbët, se i kishin vënë një armë në kohë dhe në gojë dhe se i kishin thënë se ajo ishte tradhtare e vendit të saj. **L.G.** i kishte thënë se do ta dërgonin në një 'kodër varr'.<sup>179</sup><sup>180</sup> Gjatë paraburgimit, Dëshmitari H krijoi përshtypjen se **L.G.** ishte personi përgjegjës i ushtarëve që pa Dëshmitari H.<sup>181</sup> Në Qendrën e Paraburgimit, Dëshmitari H pa një të paraburgosur tjetër, i quajtur I.S., të cilin e njohu sepse e njohte që më parë.<sup>182</sup><sup>183</sup>
- d. Dëshmitari H nuk e pa nënën e tij gjallë përsëri pasi e liruan.<sup>192</sup> Pas ca kohësh, trupi i saj u gjet në të njëjtin varr me I.S..

74. Ky dëshmitar dha një përshkrim të qartë, të gjithanshëm, jokontradiktor dhe bindës, që Trupi Gjykues e pranon si të vërtetë dhe të saktë. Faktet e paraqitura në paragrafin 73 (a) deri në (d) janë të provuara.

---

<sup>177</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 05/02/2002, f. 2; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 05/05/2002, f. 4

<sup>178</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 05/02/2002, f. 10; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 05/05/2002, f. 4

<sup>179</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 05/02/2002, pp3-5; Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 05/02/2002, f. 16; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, /05/2002, f. 5

<sup>181</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 05/02/2002, f. 11

<sup>182</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 05/02/2002, f. 11

<sup>183</sup> /02/2002, f. 6

Deklaratë para -verbal i shqyrtimit gjyqësor,  
Deklaratë para Gjyqtares Hetuese,

**75. Dëshmitari M (Ky dëshmitar ishte dëshmitar anonim, i dëgjuar vetëm nga Gjyqtarja Hetuese. Ky dëshmitar nuk u arrit të gjendej. Deklarata e tij u lexua dhe u shënuar në proces-verbal, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve më 7 maj 2013 [Shtojca C bashkëngjitur këtij Aktgjykimi])**

a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese, datë 14/03/2002

76. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitarit M dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. Dëshmitari M përshkruan se u mor nga njerëz në veshje civile në Ramadan në vitin 1999. Fillimisht atë e paraburgosën në një shitore, deri sa erdhën ushtarët e UÇK-së. Pastaj atë e rrahën dhe e dërguan në Llapashticë, ku e paraburgosën në një stallë. Ai deklaroi se e paraburgosën për 2 muaj, bashkë me rreth 10 deri në 20 të tjerë. Gjatë asaj kohe ai u intervistua nga ushtarë të UÇK-së me uniforma të zeza. Intervistat kishin të bënin me akuzat ndaj tij për bashkëpunim me serbët. Dëshmitari M mohoi ta kishin rrahur apo të ishin rrahur të tjerë.<sup>184</sup>
- b. Dëshmitari M nuk qe në gjendje të kujtonte emrat e të paraburgosurve të tjerë, përveç vëllezërve të tij. Në veçanti, M nuk qe në gjendje të jepte emrin e ndonjërit prej të paraburgosurve të tjerë në këtë lëndë, të cilët dhanë dëshmi të qarta dhe të besueshme të keqtrajtimit në shkallë të gjerë, që ata kishin pësuar në Llapashticë. Arsyja mund të jetë se Dëshmitari M nuk e pa këtë trajtim, ose të paraburgosurit e tjerë që u rrahën nuk u paraburgosën në të njëjtën kohë me Dëshmitarin M. Ose arsyja mund të jetë se Dëshmitari M thjesht nuk dëshiron të flasë. Në çdo rast, ndërsa pranohet se Dëshmitari M vërtet mund të mos jetë rrahur dhe vërtet mund të mos ketë parë ose të mos ketë pasur dijeni se të tjerët po rriheshin, kjo nuk e minon besueshmërinë e dëshmitarëve të tjerë të cilët Trupi Gjyqësor i ka pranuar si të vërtetë dhe të saktë.

77. Trupi Gjyqësor e pranon dëshminë e Dëshmitarit M për atë që ajo vërteton se në Llapashticë ekzistonte një qendër paraburgimi e drejtuar nga UÇK, në të cilën Dëshmitari M dhe të tjerë u paraburgosën dhe u morën në pyetje me akuzat e bashkëpunimit me serbët. Lidhur me rrahjet, Trupi Gjyqësor vlerëson se Dëshmitari M mund të mos jetë rrahur, ose mund të mos ketë parë të rrihen të tjerë, por kjo nuk i minon dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë për arsyet e përcaktuara më lart.

---

<sup>184</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 14/03/2002, f. 2-9



**78. Dëshmitari V (Ky dëshmitar ishte dëshmitar anonim i dëgjuar vetëm nga Gjyqtarja Hetuese. Proces-verbali u lexua dhe u shënua në proces-verbalin e shqyrtimit gjyqësor për shkak të vdekjes së dëshmitarit (shih paragrafin 4 më lart dhe Shtojcën B))**

a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese, datë 01/03/2002

79. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e Dëshmitari V dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

a. Dëshmitari V u arrestua më 06/01/1999 nga ushtarë të UÇK-së, të cilët kishin veshur uniforma të zeza. Atij i dorëzuan thirrjen me të cilën i kërkonin të paraqitej në Llapashticë. Ai shkoi në Llapashticë me djalin dhe babanë e tij. Pasi u prezantua tek ushtarët, atë e futën në një dhomë me 12-13 të paraburgosur të tjerë. Atë e rrahën që natën e parë. Ai u intervistua në të paktën 4 raste. Personi që e intervistoi kishte uniformë të zezë, por Dëshmitari V nuk ia dinte emrin. Dhoma e paraburgimit dhe dhoma e intervistës ishin rreth 10-15 metra më tutje, në të njëjtin oborr. Të gjithë të burgosurit ishin shqiptarë dhe dyert e qelisë mbaheshin të kyçur. Dëshmitari V pësoi mahisje, por jo lëndime më të rënda. Dëshmitari V kujton se bashkë me të u paraburgos edhe A.A.. Edhe kur iu treguan fotografi, Dëshmitari V këmbënguli që nuk mund t'i mbante mend njerëzit që e kishin paraburgosur dhe e kishin rrahur. Pas 12 ditëve atë e liruan, me paralajmërimin se do të bënte mirë të mos shoqërohej me serbët.<sup>185</sup>

80. Trupi Gjykses vëren se Dëshmitari dha dëshmi vetëm para Gjyqtares Hetuese, në prani të Mbrojtësit. Megjithëse rrëfimi i Dëshmitarit V është i shkurtër, ai përputhet me dëshmitë e tjera në proces-verbale dhe duhet konsideruar si vërtetim i atyre dëshmimeve. Ajo dëshmi është e besueshme dhe pranohet nga Trupi Gjykses si e saktë. Faktet e parashtruara në Paragrafin 79 (a) më lart janë të provuara.

---

<sup>185</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 01/03/2002, f. 5

**81. V.J. (dëshmia e këtij dëshmitari u lexua dhe u shënua në procesverbal në bazë të marrëveshjes së datës 07/05/2013 bashkëngjitur këtij Aktgjykimi në Shtojcën C)**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese, datë 11/07/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 12/06/2003 f. 2, 3 & 10 – dëshmia e mëparshme e V.J. u lexua dhe u shënua në procesverbal me marrëveshje të Mbrojtjes
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 10/09/2009

**82. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e V.J. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:**

- a. V.J. pranoi se para luftës kishte pasur lidhje të ngushtë me serbët, sepse ishte specializuar në sigurimin e dokumenteve të nevojshme për shqiptarët për përfitim personal. Si rezultat i kësaj veprimtarie, V.J. u arrestua nga UÇK, pasi kishte marrë thirrjen për paraqitje më 11/03/1999 dhe pasi u dorëzua në Shtab në Bradash në të njëjtën ditë. Ai u dorëzua tek ushtarët e UÇK-së në uniformë dhe atë e dërguan në Llapashticë. Në Llapashticë, atë e futën në një qeli, në një plevicë në oborrin e një shtëpie. Aty ndodheshin rreth 20 të paraburgosur të tjerë.<sup>186</sup>
- b. V.J. u mbajt në paraburgim deri nga fundi i marsit 1999. Ai nuk njohu, as identifikoi ndonjërin prej të paraburgosurve të tjerë.<sup>187</sup>
- c. Me të mbërritur atje dhe gjatë dy ditëve të para, V.J. u mor në pyetje. Ai mohoi të ishte rrahur ose trajtuar keq dhe mohoi të kishte parë të paraburgosur të tjerë të rrihen: 'Nuk e pashë asnjëherë këtë, por kisha frikë se kjo mund të ndodhte. Mendoja se ishte gjëja më e mundshme që do të ndodhte.'<sup>188</sup> Marrjet në pyetje ndodhnin në një zyrë brenda të njëjtit oborri, rreth 20 metra më tutje. Policët ishin të veshur me uniforma të zeza dhe personi që merrte në pyetje kishte një shkop. Ai pranon se gjatë marrjeve në pyetje, iu bënë kërcënime për dhunë kundër tij, por në fakt nuk e rrahën asnjëherë. Gjatë marrjes në pyetje, V.J. duket se ka pranuar gjithçka në mënyrë

---

<sup>186</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 11/07/2002, f. 2-5, Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/09/2009, f. 10-11

<sup>187</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 11/07/2002, f. 6; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 10/09/2009, f. 10

<sup>188</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese 11/07/2002, f. 8

të plotë dhe të gjithanshme para UÇK-së për sjelljen e tij.<sup>189</sup> Në shqyrtimin gjyqësor në vitin 2009, V.J. në fakt mohoi të kishte pasur ndonjë marrje në pyetje.<sup>190</sup>

- d. V.J. deklaroi se, megjithëse kishte mësuar për **L.G.** dhe **N.M.** nga të tjerë, dhe se ata ishin të rëndësishëm, ai mohoi t'i ketë parë në Llapashticë.
- e. V.J. pranoi se në paraburgim ishte një person i quajtur A., por nuk e dinte me siguri se ky ishte A.K.. Ai gjithashtu dinte se H.J. ishte në paraburgim.

83. Trupi Gjyqësor vlerëson se ky dëshmitar u përpoq të minimizonte përkrahimin e ngjarjeve në Llapashticë nga ana e tij, në veçanti duke e kufizuar përkrahimin e tij vetëm tek vetvetja dhe duke parapëlqyer të minimizojë përmendjen ose ngjarjet lidhur me ndonjë të paraburgosur tjetër. Fakti që ai po e minimizonte përkrahimin u bë edhe më i qartë nga mohimi nga ana e tij në vitin 2009 se nuk kishte pasur as marrje në pyetje, ndërkohë që në vitin 2002 ai kishte dhënë një përkrahim të qartë dhe të hollësishëm të procesit të marrjes në pyetje. Për sa i takon vetes së tij, sipas përkrahimit të tij duket se ai e ka pranuar menjëherë çdo akuzë të bërë gjatë marrjes në pyetje, ndërsa të tjerët të cilët dhanë dëshmi, thanë se ishin rrahur kur i kishin mohuar akuzat. Prandaj rrjedh se, në këto rrethana, ka të ngjarë që ai të mos jetë rrahur. Fakti që atë nuk e rrahën, nuk ndikon në dëshmitë e atyre dëshmitarëve të cilët thanë se u rrahën. Gjithashtu, V.J. ishte në paraburgim për një periudhë të shkurtër, shumë më të shkurtër se të paraburgosurit e tjerë. Prandaj rrjedh se ai nuk ka si të japë një përkrahim të ngjarjeve që mund të kenë ndodhur jashtë periudhës së paraburgimit të tij. Prandaj Trupi Gjyqësor mbështet mendimin se V.J. vërteton faktet se në Llapashticë ndodhën paraburgime, se ndodhën marrje në pyetje nga oficerë të Policisë Ushtarake, të cilët mbanin shkopinj dhe u bënë kërcënime, ndonëse vetë V.J. nuk u rrah. Ai nuk e di nëse u rrahën të tjerë dhe nuk i ka parë rrahjet vetë.

**84. F.M. (i thirrur në emër të Mbrojtjes dhe dëshmia e të cilit u lexua dhe u shënua në proces-verbal në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve më datë 07/05/2013)**

- a. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 15/05/2003

---

<sup>189</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese 11/07/2002, pp10-12

<sup>190</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 10/09/2009, f. 12

85. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e F.M. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. Më 07/01/1999, F.M. mori fletë-thirrje nga UÇK për të shkuar në Llapashticë. Ai e zbatoi thirrjen dhe u paraqit në mëngjesin e datës 08/01/1999. Në Llapashticë, atë e dërguan në një zyrë dhe u intervistua nga Komandant **xxxxx**. Marrja në pyetje kishte të bënte me përdorimin nga serbët të kafenesë së F.M. . Pas intervistës, atë e dërguan në një dhomë paraburgimi me rreth 5-6 të burgosur të tjerë, përfshirë I.S.. Pas 3 ditësh, F.M. u intervistua përsëri nga Komandant **xxxxx**, i cili i bëri të njëjtat pyetje. F.M. mohon që t'i jetë bërë ndonjë kërcënim ose keqtrajtim. Pas disa ditësh ndodhi një intervistë e tretë për të njëjtën arsye, me Komandant **xxxxx**. Pas totalit prej 8 ditësh, F.M. e liruan.<sup>191</sup> Pas luftës, F.M. pa nga një fotografi se Komandant **xxxxx** ishte **N.M.**.<sup>192</sup>
- b. F.M. theksoi se pjesën më të madhe të kohës në paraburgim, ai u shoqërua vetëm me një të burgosur të quajtur B., dhe ndonjëherë me A.A.. Ai nuk diskutoi me të burgosurit e tjerë nëse ata ishin marrë në pyetje, sepse 'nuk i interesonin problemet e tyre'. Ai nuk kishte dëgjuar për ankesa nga të tjerë për trajtimin e tyre.<sup>193</sup>

86. Trupi Gjykses vëren se F.M. u paraburgos për një kohë shumë të shkurtër krahasuar me të paraburgosurit e tjerë. Prandaj ai nuk mund të japë shpjegime për ato që ndodhën ose nuk ndodhën kur ai nuk ishte në paraburgim. Në të njëjtën mënyrë, ai duket se e ka mbajtur veten të shkëputur nga të paraburgosurit e tjerë, duke mos treguar interes ose shqetësim për ta dhe mbarëvajtjen e tyre. Çfarëdo t'u ketë thënë personave të UÇK-së që bënë marrjen në pyetje, duket se ai i ka kënaqur ata në një mënyrë që të paraburgosurit e tjerë nuk e bënë. Fare mirë F.M. mund të mos jetë rrahur. Kjo nuk e ul vlerën e dëshmive të të tjerëve që u rrahën. Trupi Gjykses pranon se dëshmia e F.M. është e vërtetë për atë që ajo ka të bëjë me vetë F.M.. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se F.M. nuk ka dëshmi të dobishme për të dhënë për ato ngjarje që kanë të bëjnë me dëshmitarët e tjerë.

---

<sup>191</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/05/2003, f. 2-4

<sup>192</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/05/2003, f. 5

<sup>193</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/05/2003, f. 4

**87. G.Z. (i thirrur në emër të Mbrojtjes dhe dëshmia e të cilit u lexua dhe u shënuar në proces-verbal në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve, datë 07/05/2013)**

a. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor, datë 15/05/2013

88. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e G.Z. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. G.Z. kishte qenë pjesëtar i UÇK-së nga viti 1998 deri në përfundim të luftës, detyrat e të cilit përfshinin paraburgimin e të burgosurve në Llapashticë. Ai mohon të ketë ndodhur ndonjë keqtrajtim i të burgosurve. Ai pohon se të gjithë të paraburgosurit u liruan kur filluan bombardimet e NATO-s në mars 1999.<sup>194</sup>
- b. G.Z. pranon se eprori i tij në atë kohë ishte **N.M.**. Ai deklaron se Shtabi i Zonës ishte rreth 1 – 1.5 kilometra larg Shtabit të Policisë Ushtarake ku mbaheshin të paraburgosurit. G.Z. deklaron se e dinte emrin e **L.G.** dhe e pa atë një a dy herë gjatë luftës. G.Z. konfirmoi se atje ndodheshin rreth 15-16 të burgosur. Ai mohoi të kishte ndodhur ndonjë keqtrajtim ose marrje në pyetje. Ai tha se **N.M.** lëshoi një urdhër që të burgosurit të mos keqtrajtoheshin. Ai deklaroi se arsyeja e paraburgimeve ishte se të paraburgosurit kishin pasur kontakte të papëlqyeshme me serbët dhe se ‘ne duhej t’i merrnim në pyetje, t’i këshillonim dhe t’i disiplinonim’, megjithëse ai mohoi të kishte dijëni se kush ishte ai që merrte në pyetje, të kishte parë ndonjëherë këshillimin e tyre, apo të dinte se çfarë kuptohej me ‘disiplinim’.<sup>195</sup>
- c. Ai konfirmoi se A.K., H.J. dhe D. ishin të paraburgosur në Llapashticë.<sup>196</sup>

89. Trupi Gjykues vëren se pohimi për distancën ndërmjet Shtabit të Zonës dhe kompleksit të paraburgimit të Policisë Ushtarake është në mospërputhje të plotë me të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, dhe në mospërputhje me dëshmitë e të pandehurve, të cilët të gjithë vlerësuan se distanca ishte rreth 20-200 metra. Trupi Gjykues e hedh poshtë si të pavërtetë pohimin se **L.G.** ishte në Shtabin e Zonës / kompleksin e Policisë vetëm ‘një a dy herë’, po të kemi parasysh peshën e ndjeshme të provave dhe dëshmimeve në

---

<sup>194</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/05/2003, f. 7-8

<sup>195</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/05/2003, f. 8-9

<sup>196</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor, 15/05/2003, f. 10

të kundërt. Më tej, këto dy deklarata qartazi të pasakta njollosin dhe zhvlerësojnë pjesën tjetër të dëshmisë së G.Z.. Krahas kësaj, pohimi i G.Z. se nuk kishte pasur marrje në pyetje, i pasuar nga pohimi se ishte e nevojshme që të paraburgosurit të 'merreshin në pyetje, të këshilloheshin dhe disiplinoheshin', nuk është i besueshëm. Po kështu, Trupi Gjykses thekson dëshminë e K.H. (shih Paragrafin 91 më poshtë) se intervistimi i të paraburgosurve ndodhi vërtet në zyrën e **N.M.**

Qartazi nuk mund të ndodhë që G.Z. dhe K.H. të kenë të drejtë të dy, dhe përshkrimi i K.H. është më në përputhje me peshën e dëshmive dhe provave të tjera në lëndë. Prandaj, përveç konfirmimit se në Llapashticë ekzistonte një qendër paraburgimi e UÇK-së, se **N.M.** ishte eprori i tij në Policinë Ushtarake dhe se A.K., H.J. dhe D. ishin të gjithë të paraburgosur atje, Trupi Gjykses e hedh poshtë dëshminë e G.Z. si të pambështetshme.

**90. K.H. (i thirrur në emër të Mbrojtjes dhe dëshmia e të cilit u lexua dhe u shënua në proces-verbal në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve më datë 07/05/2013)**

- a. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 16/05/2013
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 16/05/2013
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 10/07/2009

91. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e K.H. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. K.H. ishte ushtar i UÇK-së, i cili punonte si xxx në Qendrën e Paraburgimit në Llapashticë. Eprori i tij ishte Komandant **xxxxx**, **N.M.**<sup>197</sup>
- b. K.H. ishte në Llapashticë për rreth 1 muaj. Gjatë asaj kohe, atje ndodheshin rreth 20 të paraburgosur. Të paraburgosurit dërgoheshin në zyrën e **N.M.** për marrje në pyetje, që K.H. konsideron zgjaste çdo herë rreth 10-15 minuta dhe jo 45-50 minuta.

---

<sup>197</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 16/05/2013, f. 5; Proces-verbal i shqyrtimit gjyqësor 10/07/2009, pp2-5

92. Trupi Gjykues gjen se dëshmia e K.H. i shtoi pak lëndës, përveç se konfirmoi praninë e Qendrës së Paraburgimit të UÇK-së në Llapashticë, se **N.M.** xxxx dhe se ka pasur marrje në pyetje e të paraburgosurve.

93. **S.G. (i thirrur në emër të Mbrojtjes dhe dëshmia e të cilit u lexua dhe u shënuar në proces-verbal në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve më datë 07/05/2013)**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 17/07/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqësor më 15/07/2009

94. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e S.G. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmblihet si më poshtë:

- a. S.G. e përshkruan veten si kushëri të largët të **L.G.**.
- b. S.G. ishte polic ushtarak i UÇK-së, me shërbim në Llapashticë. Komandant i tij ishte **N.M.**. Ai konfirmon se në të njëjtin kompleks ku ndodhej Shtabi i Policisë Ushtarake, ekzistonte një qendër paraburgimi. Ai kishte dijeni se atje ishte një e paraburgosur femër dhe disa burra të paraburgosur, por nuk e dinte se kush ishin, ose arsyet përse ishin paraburgosur. Megjithëse gjatë gjithë dëshmisë së tij **L.G.** u duk se tregoi mungesë të jashtëzakonshme interesi se kush ishte paraburgosur dhe çfarë ishte mbarëvajtja e tyre, ai ishte në dijeni se F.M. ishte paraburgosur dhe liruar<sup>198</sup> dhe ai mësoi nga G.Z. ose nga K.H. se I.S., A.T., D. dhe V. ishin paraburgosur.<sup>199</sup>
- c. S.G. mohoi të kishte dijeni për ndonjë intervistim të të paraburgosurve, por gjithashtu tha se nuk kishte qenë gjithë kohës i pranishëm në Llapashticë.
- d. S.G. konfirmon se **xxxx** ishte komandant i Zonës. Ai mohon ta ketë parë **L.G.** prezent në më shumë se 2 ose 3 raste.

95. Trupi Gjykues vlerëson se ky dëshmitar jep dëshmi me peshë minimale. Ai pretendon se ka pak, ose nuk ka aspak, të bëjë me atë se kush u paraburgos ose përse. Informacioni që ai pranon se e kishte lidhur me identitetin e të paraburgosurve, ai thotë se i erdhi nga të tjerët. Ai mohoi të kishte hyrë

---

<sup>198</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 17/07/2002, f. 2-4

<sup>199</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 17/07/2002, f. 6

ndonjëherë në Qendrën e Paraburgimit dhe të ketë kontrolluar për mbarëvajtjen e të paraburgosurve. Përgjithësisht, ai pretendon se ka kujtesë shumë të pakët të ngjarjeve. Trupi Gjykses i bashkëngjit pak peshë deklarimit të tij.

**96. N.I. (i thirrur në emër të Mbrojtjes dhe dëshmia e të cilit u lexua dhe u shënuar në proces-verbal në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve, siç është shënuar në Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqsor më datë 08/05/2013, f. 29, Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqsor më datë 10/05/2013, f. 14 dhe Shtojcën C)**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 27/08/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqsor më 23/05/2003
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqsor më 15/07/2009

97. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e N.I. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmbliidhet si më poshtë:

- a. N.I. ishte xxxxxxxxxxxx në Zonën e Llapit dhe MË PAS xxxxxxxxxxxx Zonës së Llapit. Si Shef Shtabi, ai u stacionua në Katunishte dhe jo në Llapashticë. Ai konfirmon se xxxxxx ishte Komandant i Zonës dhe se L.G. ishte 'xxxxxxxxx'. Ai pranoi se paraburgoseshin dhe merreshin në pyetje bashkëpunëtorë civilë të dyshuar, por konsideroi se këto paraburgime zgjatnin vetëm një ose dy ditë, jo muaj. Ai e dinte se qendra e paraburgimit ishte në Llapashticë. Ai mohoi të kishte dijeni se kush e kishte paraburgosur I. S..<sup>200</sup>
- b. Në shqyrtimin gjyqsor në vitin 2009, N.I. deklaroi se shkoi në Llapashticë vetëm dy herë.<sup>201</sup> Megjithëse thotë se ai mbeti i kënaqur me mënyrën se si mbaheshin të paraburgosurit, kjo duket se është arritur thjesht duke pyetur një person të pidentifikuar dhe pa parë ose pa folur me të paraburgosurit, ose edhe duke e vizituar vetë qelinë.<sup>202</sup>

98. Është e qartë se N.I. ose nuk është në gjendje, ose nuk dëshiron të japë ndonjë të dhënë të rëndësishme rreth ngjarjeve në Llapashticë. Sipas

---

<sup>200</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 27/08/2002, f. 2-14

<sup>201</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqsor, 15/07/2009, f. 9

<sup>202</sup> Proces-verbal i shqyrtimit gjyqsor, 15/07/2009, f. 10-11



përshkrimit të vetë atij, ai ishte prezent atje vetëm dy herë, dhe tentativat e tij për të siguruar që të paraburgosurve t'u ofrohej kujdesi i duhur, ishin në rastin me të mirë qesharake. Trupi Gjykses nuk i jep peshë dëshmisë së tij lidhur me ngjarjet në Llapashticë.

**99. K.K. (i thirrur në emër të Mbrojtjes dhe dëshmia e të cilit u lexua dhe u shënua në proces-verbal në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve, siç është shënuar në Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqsor më datë 08/05/2013, f. 29, Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqsor më datë 10/05/2013, f. 14 dhe Shtojcën C)**

- a. Deklarata para Gjyqtares Hetuese më 03/09/2002
- b. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqsor më 16/06/2003
- c. Proces-verbali i Shqyrtimit Gjyqsor më 09/09/2009

100. Duke rishqyrtuar të gjithë dëshminë e K.K. dhe duke hequr ato pjesë që kanë rëndësi për akuzën e vetme të mbetur para gjykatës, kjo dëshmi mund të përmbliidhet si më poshtë:

- a. K.K. ishte xxx i Zonës së xxx. **R.M.**, 'xxxxx', ishte xxx. Me zhvillimin e luftës, Zona kishte 2 shtabe, një në Llapashticë dhe një në Kotunishte. Në Llapashticë ishte Shtabi zyrtar dhe në Kotunishte ishte Shtabi sekret. K.K. e kaloi pjesën më të madhe të kohës me zëvendësin e tij, N.I., në Kotunishte. Kjo ishte nga fundi i nëntorit / fillimi i dhjetorit 1998. xxxxx dhe **L.G.** u vendosën në Llapashticë. **L.G.** ishte zyrtarisht Shef i Shërbimeve Informative, por K.K. mbështet pohimin e **L.G.** se detyrat e tij në luftë nuk e lejuan asnjëherë ta përmbushte atë detyrë.<sup>203</sup>
- b. Detyra e Policisë Ushtarake të komanduar nga **N.M.** ishte të merrej me bashkëpunëtorët. K.K. ishte në dijeni se njerëzit që dyshoheshin për bashkëpunim, paraburgoseshin. Komanda vendoste se kush duhej paraburgosur, bazuar në raportet e përgatitura nga **L.G.**<sup>204</sup>
- c. K.K. e bëri të qartë se kishte pak interes dhe i kushtoi pak kohë çështjes së të paraburgosurve. 'Duke filluar nga 24 dhjetori 1998, unë u përballa me sulme të vazhdueshme nga serbët, prandaj nuk kisha kohë për të gjitha këto.'<sup>205</sup> Megjithëse e dinte se të

<sup>203</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 03/09/2002, f. 2-4

<sup>204</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 03/09/2002, f. 5-7

<sup>205</sup> Deklaratë para Gjyqtares Hetuese, 03/09/2002, f. 10

paraburgosurit mbaheshin në Llapashticë, ai nuk e kishte vizituar asnjëherë qendrën e paraburgimit.<sup>206</sup> Ai mohoi të kishte dijeni për emrat e të paraburgosurve.<sup>207</sup>

101. Në të njëjtën mënyrë si N.I., është e qartë se K.K. kishte pak kontakt të drejtpërdrejtë me Llapashticën. Megjithëse ai shkonte atje për mbledhje të Komandës kur i kërkohet, vendndodhja parësore e tij ndodhej gjetiu. Përfshirja e tij në ngjarjet në Llapashticë, dhe në veçanti me të paraburgosurit, ishte minimale. Prandaj, pesha e dëshmisë së tij lidhur me këto çështje është domosdo e kufizuar.

## **PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE**

102. **Përgjegjësia penale e L.G.** – faktet të gjetura si të provuara në këtë lëndë përcaktojnë se:

- a. Në të gjitha kohët materiale ekzistonte gjendja e konfliktit të armatosur të brendshëm, në të cilin vlenin për zbatim Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë.
- b. UÇK ishte një trupë e organizuar ushtarake e angazhuar në luftime.
- c. Në Llapashticë ekzistonte një Shtab i Zonës, dhe brenda një distance të shkurtër të Shtabit të Zonës ekzistonte një Shtab i Policisë Ushtarake dhe një Qendër Paraburgimi. Qelia e paraburgimit ishte një stallë/plevicë, në të cilën kushtet ishin ato bazë dhe të kufizuara. Numri i të paraburgosurve të mbajtur atje ndryshonte dhe shkoi deri në rreth 20 persona.
- d. Se dëshmitarët e identifikuar më lart u paraburgosën. Në të gjitha kohët materiale ata gëzonin statusin e personave të mbrojtur sipas Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë.
- e. Në shkelje të të drejtave dhe privilegjeve të personave të mbrojtur, të paraburgosurit u rrahën dhe torturuan, me qëllim që prej tyre të nxirreshin rrëfime për bashkëpunim me serbët.
- f. **L.G.** ishte **xxxxxxxxxxxxxxxx** për Zonën e **xxxx** dhe de fakto drejtonte Policinë Ushtarake dhe ishte epror i **N.M.**.
- g. **L.G.**, si **xxxxxxxxxxxxxxxx**, pati përfshirje qendrore në funksionimin e Qendrës së Paraburgimit në Llapashticë. Ai mban përgjegjësi si

---

<sup>206</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 03/09/2002, f. 12

<sup>207</sup> Deklaratë para Gjyqtarës Hetuese, 03/09/2002, f. 14

komandimi, ashtu dhe të drejtpërdrejtë personale për drejtimin e paraburgimeve të paligjshme, rrahjeve dhe torturimit të të paraburgosurve, dhe u angazhua personalisht në marrjen në pyetje të viktimave ndërkohë që ato rriheshin.

103. **Përgjegjësia penale e N.M.** - faktet e gjetura si të provuara në këtë lëndë përcaktojnë se:

- a. Paragrafët 102(a) deri në (e) përsëriten në këtë pjesë.
- b. Në të gjitha kohët materiale, **N.M.** ishte **xxxxxxxxxxxxxx**, i cili mbikëqyrte rojet e Qendrës së Paraburgimit dhe i raportonte eprorit të drejtpërdrejtë të tij, **L.G.**.
- c. **N.M.** ishte përgjegjës për mbajtjen e të paraburgosurve në paraburgim dhe për dërgimin e të paraburgosurve për marrje në pyetje, duke qenë plotësisht në dijeni se këto marrje në pyetje përfshinin rrahjet dhe torturën, me qëllim që prej tyre të nxirreshin rrëfime të bashkëpunimit. Krahas kësaj, **N.M.** luajti rol personal aktiv në shkaktimin e rrahjeve.

104. **Përgjegjësia penale e R.M.** - faktet e gjetura si të provuara në këtë lëndë përcaktojnë se:

- a. Paragrafët 102(a) deri në (e) përsëriten në këtë pjesë.
- b. Në të gjitha kohët materiale, **R.M.** ishte xxx i Zonës së xxx.
- c. Në të gjitha kohët materiale, **R.M.** si xxxxx i Zonës, epror i **L.G.**, të cilin **R.M.** e kishte përzgjedhur dhe emëruar. **R.M.** ishte përgjegjës dhe drejtonte regjimin e paraburgimeve të paligjshme, rrahjeve dhe torturës, dhe ishte plotësisht në dijeni se kjo sjellje po ndodhte nën autoritetin e tij. Trupi Gjykoës arrin në përfundimin se **R.M.** kishte marrëdhënie të ngushtë me **L.G.**, i cili e dinte se veprimet e tij ndërmerreshin me miratimin dhe mbështetjen e qartë të **R.M.** . Për rrjedhojë, **R.M.** mban përgjegjësi komandimi për sjelljen në Qendrën e Paraburgimit të Llapashticës.

## CAKTIMI I DËNIMIT

105. Të përgjithshme

- a. Në vitin 1998, shtetasit shqiptarë të Kosovës u ngritën kundër shtypjes masive që u ishte imponuar atyre nga regjimi i Milosheviçit.
  - b. UÇK, duke vepruar në emër të shtetasve shqiptarë të Kosovës, zhvilloi një luftë me synimin për të siguruar lirinë dhe pavarësinë për të ardhmen e tyre, një luftë për të cilën shumë janë krenarë me të drejtë. Asgjë që thotë ose bën ky Trup Gjykues në lidhje me këtë lëndë, nuk mund të shihet si kritikë ose kundërshtim i asaj krenarie.
  - c. Ka disa njerëz, shpesh në nivele të larta, të cilët gabimisht sugjerojnë se pjesëtarë individualë të UÇK-së nuk bënë asgjë të gabuar dhe se çdo aktgjykim dënues i një pjesëtari të UÇK-së është një kundërshtim ndaj integritetit të tërë UÇK-së. Të njëjtët njerëz ndonjëherë sugjerojnë se, për shkak se ishte Regjimi Serb ai që e provokoi konfliktin, atëherë vetëm serbët duhet të përballen me procese gjyqësore. Të dy sugjerimet janë thjesht të gabuara dhe atyre mund t'u jepet përgjigje në këtë mënyrë:
    - i. Së pari - kur dënohen individë për veprimet e tyre, janë vetëm ata që mbajnë përgjegjësi dhe jo tërë institucioni të cilit i kanë shërbyer;
    - ii. Së dyti: edhe sikur konfliktin ta ketë provokuar sjellja e regjimit të Milosheviçit, kjo nuk u jep të shtypurve lirinë të sillen në mënyrë të pakontrolluar, të paligjshme, kriminale.
106. Përkundrazi, ajo që e ul integritetin e UÇK-së është mohimi në vazhdimësi që ndonjë individ të ketë kryer ndonjë veprë të dënueshme.
107. Në këtë lëndë ka prova të qarta, të besueshme dhe bindëse se këta tre të pandehur kryen akte të paligjshme ndaj kosovarëve shqiptarë, të cilët ata i morën në paraburgim. Pavarësisht se sa veprime pozitive dhe të mira që këta të pandehur mund të kenë ndërmarrë, në kryerjen e akteve kriminale që kjo gjykatë i gjen të provuara, këta të pandehur iu larguan shumë standardeve të larta që populli i Kosovës priste me të drejtë nga pjesëtarët e UÇK-së.
108. Me këto dënime Trupi Gjykues thekson se janë vetëm këta tre të pandehur që gjenden se kanë vepruar në mënyrë të paligjshme, dhe jo tërë UÇK. Në rast se ndokush do të sugjeronte të kundërtën, ai vepron thjesht nga një pikëpamje politike fikse dhe zgjedh të shpërfillë dëshmitë dhe provat dërrmuese në të kundërt.

109. Në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses duhet të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe ata rëndues.

110. Si pasojë e aktvendimit të Gjykatës Supreme, Ap.-Kz. nr. 89/2010, datë 26 janar 2011, ky Grup Gjykses nuk mund ta tejkalojë dënimin në lidhje me secilin prej këtyre të pandehurve, që u caktua nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës, P. Nr. 526/05, datë 2 tetor 2009, që është maksimumi 6 vjet burgim për **L.G.**, 3 vjet burgim për **N.M.** dhe 4 vjet burgim për **R.M.**

111. **L.G.**

a. Faktorët rëndues:

- i. Roli qendror në një regjim të paraburgimeve të paligjshme, marrjes në pyetje dhe torturës.
- ii. Përgjegjësia komanduese dhe përgjegjësia personale për rrahjet në shkallë të gjerë.
- iii. Numri i viktimave të cilat/cilët duruan frikë, vuajtje të mëdha vetjake dhe mungesë të dinjitetit, bashkë me ankthin dhe frikën e familjarëve të tyre .

b. Faktorët lehtësues

- i. Nuk ka pasur dënime të mëparshme.

c. Trupi Gjykses vlerëson se dënimi i saktë (për shkak të kufizimit ekzistues të përcaktuar në paragrafin 110 më lart) për Akuzën 8 është pesë (5) vjet burgim.

d. **L.G.** do të vuajë dënimin unik sipas Akuzave 5, 8 dhe 14 prej gjashtë (6) vitesh burgim.

112. **N.M.**

a. Faktorët rëndues

- i. Përgjegjësia e drejtpërdrejtë personale për regjimin e paraburgimeve të paligjshme, rrahjet dhe torturën, që ishin autorizuar dhe miratuar nga të tjerë.
- ii. Përfshirja e drejtpërdrejtë personale në rrahjet në shkallë të gjerë.

- iii. Numri i viktimave të cilat/cilët duruan frikë, vuajtje të mëdha vetjake dhe mungesë të dinjitetit, bashkë me ankthin dhe frikën e familjarëve të tyre .
- b. Faktorët lehtësues
  - i. Nuk ka pasur dënime të mëparshme
- c. Trupi Gjykses vlerëson se dënimi i saktë (për shkak të kufizimit ekzistues të përcaktuar në paragrafin 110 më lart) për Akuzën 8 është tre (3) vjet burgim.
- d. **N.M.** do të vuajë dënimin unik sipas Akuzave 5 dhe 8 prej tre (3) vitesh burgim.

**113. R.M.**

- a. Faktorët rëndues
  - i. Përgjegjësia komanduese dhe roli kyç në krijimin e një sistemi të paraburgimeve të paligjshme, rrahjes dhe torturës, bashkë me miratimin dhe mbështetjen në vazhdimësi të tyre gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës.
  - ii. Numri i viktimave të cilat/cilët duruan frikë, vuajtje të mëdha vetjake dhe mungesë të dinjitetit, bashkë me ankthin dhe frikën e familjarëve të tyre.
- b. Faktorët lehtësues
  - i. Nuk ka pasur dënime të mëparshme
- c. Trupi Gjykses vlerëson se dënimi i saktë (për shkak të kufizimit ekzistues të përcaktuar në paragrafin 110 më lart) për Akuzën 8 është katër (4) vjet burgim.
- d. **R.M.** do të vuajë dënimin unik sipas Akuzave 5 dhe 8 prej katër (4) vitesh burgim.

114. Në bazë të Nenit 50 të KPRSFJ-së dhe Nenit 351(1)(6) të LPP-së, të pandehurit kanë të drejtën e llogaritjes në dënim edhe të kohës së kaluar në paraburgim deri më tani.

Gjykatësi Jonathan Welford-Carroll  
Kryetar i Trupit Gjykses

Emiliya Viktorova  
Procesmbajtës

Përgatitur në anglishte, gjuhë e autorizuar.

*Mjet ligjor:*

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij Aktgjykimi në Gjykatën e Apelit, përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data që u dorëzohet kopja e këtij Aktgjykimi, sipas Neni 359(1) të LPP-së.